

VALENTINA LESKAJ  
**POLITIKA SI IDE**  
REFLEKSIONE

---

BOTIMET TOENA



VALENTINA LESKAJ

POLITIKA SI IDE

*Intervistë e realizuar nga  
Alda Bardhyli*

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2021

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Roland Tasho

ISBN 978-9928-348-01-2

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.al](http://www.toena.al)

*"Me fjalën demokraci nuk kuptojmë vetëm sistemet, institucionet dhe marrëdhëniet midis tyre, kjo është demokracia teknike, por në radhë të parë ajo është marrëdhënie me botën dhe shoqërinë, mënyrë mendimi, shpirti i jetës publike. Teknologjia e demokracisë është e pakonceptueshme pa kulturën demokratike."*

Vaclav Havel



## PARATHËNIE

Libri “Politika si ide” e znj. Valentina Leskaj, është një narrative e tri dekadave të eksperiencës personale politike dhe shoqërisë civile, një rrëfenjë e një tranzicioni epokal të shoqërisë njerëzore në tërësi, dhe të vendit tonë, Shqipërisë, në veçanti. Teksa e kam lexuar gjatë përgatitjes për botim, jam zbavitur prej larmisë së tematikave të trajtuara; zhvendosjeve në kohë dhe në hapësirë që krijohen në secilën prej tyre; personalizimi i ideve tek individë të caktuar, të shquar të fushave, e njëherësh abstraksioni si teorizim mbi fenomenet; prekja emocionale që të krijojnë trajtimi i grupeve vulnerabël, dhe ftohtësia që ruhet në raport me dështimet konsekuente të politikave publike; ecjes kritike në linjën e përfaqësimit të saj ideologjik, përballë dështimeve në artikulimin e politikave publike nga të dyja kahet e spektrit politik shqiptar.

Ky libër nis me një tekst të shkruar për gruan, lëvizjen feministe dhe të drejtat e gruas në shoqëri. Them se nuk mund të kishte nisje më të duhur për një grua, që, edhe vetë në veprimtarinë e saj, si dëshmohet përgjatë faqeve

të të gjithë librit, ka kaluar në kauza në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Angazhimi politik dhe aksioni publik qytetar lidhen pazgjidhshmërisht me zbulimin e forcës së gruas dhe me vërtetimin e tezës se shoqëritë, që kanë ditur të angazhojnë gruan në punët e vendit, ia kanë dalë të ndërtojnë familje të shëndetshme dhe shoqëri të shëndetshme, ashtu sikurse dhe demokracia është bërë më funksionale. Ndërsa shoqëria njerëzore ka kaluar nga epoka e matriarkatit tek ajo e patriarkatit, sot po predikojmë të ndërtojmë një shoqëri që ruan një rol të barabartë për të dyja anët e ekuacionit të zhvillimit, të burrit dhe gruas. Vendet që ia kanë dalë të gjejnë më mirë këtë balancë, janë edhe vendet me nivelet më të larta të mirëqënies njerëzore dhe harmonisë sociale. Znj. Leskaj e ka përcjellë mesazhin e saj edhe përmes kontributeve të konferencave shkencore ndërkombëtare, duke qenë dhe vetë protagoniste.

Një temë me shumë interes, që trajtohet në libër, është ajo e pjekurisë demokratike të shoqërisë. Si një shoqëri me trashëgimi deficitare në fushën e demokracisë, si një vend ku dhe eksperimenti komunist u zbatua në formën e vet më ortodokse ekstreme, nuk mund të pritej që transpozimi i sistemit të ri të vinte pa probleme dhe në mënyrë të butë. Sistemet nuk janë si direktivat e BE-së që mund të transpozohen nga departamentet juridike, sepse demokracia është mënyrë organizimi dhe ideal shoqëror, që bazohet në respektimin e parimeve fundamentale, që e bëjnë atë një sistem të besueshëm nga e gjithë shoqëria. Përgjegjshmëria, llogaridhënia dhe *checks and balance*



në ndërtimin e strukturës së qeverisjes së vendit, janë kritike që qytetarët të ruajnë besimin te demokracia, te pushteti i votës së tyre. Fatkeqësisht, siç e pohon dhe autorja në libër, nuk ia kemi dalë të ndërtojmë një demokraci funksionale, ku shteti ligjor, rendi dhe ligji të funksionojnë sipas parametrave të një shoqërie moderne europiane. Personalizimi i pushteteve, por dhe i segmenteve të rëndësishme të jetës ekonomike, kaq i dukshëm në kontekstin shqiptar, bie në kontrast të thellë me natyrën impersonale të institucioneve qeverisëse dhe transaksioneve në ekonomi, që duhet të ekzistojnë në një shoqëri demokratike dhe në një shoqëri të tregut të lirë. Deficiti demokratik është një arsye madhore e lodhjes dhe e zhgënjimeve të shoqërive që dolën nga sistemet totalitare, të sjella mjeshtërisht nga autorë të njohur sot, më së fundmi, edhe nga shkencëtari politik Ivan Krastev, me librin e tij me bashkautorësi me Stephen Holmes-in, “The Light that Failed”. Kjo është një temë qendrore edhe e këtij libri dhe mendoj se përbën një kontribut në trajtimin e këtij problemi specifikisht në kontekstin shqiptar.

Konflikti politik si mungesë idesh dhe roli i medias si amplifikuese e së keqes dhe e konfliktit, mund të konsiderohen si një prej faktorëve që kanë mbjellë dëshpërim te publiku dhe kanë prodhuar këto zhgënjime të thella tek e gjithë klasa politike, e që mund të shndërrohen në një mosbesim te vetë sistemi. Gjuhën e urrejtjes që e ndesh në politikë - që nga Parlamenti dhe në retorikën e përditshme politike - autorja me të drejtë e sheh si... “një

problem i madh për vetë moralin e shoqërisë, e cila bëhet e rrezikshme sidomos kur ndikon të të rinjtë duke nxitur një kulturë të dëmshme për brezat dhe për fat të keq kjo situatë po lë gjurmë”.

Dhuna verbale dhe konfliktualiteti në shoqërinë e sotme, nuk janë një problem thjesht shqiptar, por një çështje shqetësuese që merr shumë mprehtësi në kushtet e përparimit të sotëm teknologjik. Populizmi në politikë, që vitet e fundit është një fenomen kaq shumë i përhapur në botë, i ka dhënë më shumë zë grupeve ekstremiste dhe votuesi “median” është pa zë.

Raporti delikat midis lirisë së fjalës, fuqisë së teknologjisë për të depërtuar përmes rrjeteve sociale në mënyrë personale tek e gjithë popullata përdoruese, efektivisht të gjithsecili prej nesh, dhe rregullimit të këtij ekuilibri, kanë marrë së fundmi trajtat e një konflikti të madh mes politikës, si ushtruese e rregullimit, dhe medias sociale (dhe shoqërisë) si promotore të lirisë së shprehjes. Raporti i teknologjisë dhe i rregullimit është gjithnjë problematik, sidomos kur ndryshimet janë paradigmale.

Ndasitë politike, siç e thotë autorja me të drejtë në libër, vazhdojnë të mbeten të thella. Fakti që ne biem dakord pa dallime politike për çështje të debatit global, të themi me përkufizimin e antisemitizmit, por nuk biem dakord me dënimin e krimeve të komunizmit, është një tregues se e shkuara dhe dallimet në raport me të kanë rrënjë shumë të thella. Mendoj se në një kuptim, ndryshimi i

vërtetë social në Shqipëri do të realizohet kur shoqëria të jetë gjakftohtë në gjykimin e historisë së shkuar, duke i vendosur palët në histori në ekuidistancë.

E tillë është edhe ndarja në të majtë dhe të djathtë; ajo nuk është një çështje e raportit të individit me pasurinë apo pozicionin e tij në shoqëri, por çështje e raportit të individit me lirinë, e mënyrës se si dikush e percepton raportin individ-shoqëri. Dhe kjo do të thotë se të qenët i pasur nuk të bën domosdoshmërisht të djathtë, ashtu sikurse të qenët me të ardhura ekonomike modeste nuk të bën domosdoshmërisht të majtë. Për më shumë, në një botë që po rend kaq fort pas materializmit, rikthimi drejt metafizikës, drejt idesë, drejt shpirtit njerëzor, po prek gjithnjë e më shumë individë, përfshi dhe *tycoon* të mëdhenj të kapitalit. *Business Round Table*, për shembull, është një iniciativë e një grupi kompanish shumëkombëshe, ndër më të mëdhatë amerikane, që po promovon një ndryshim të rëndësishëm në natyrën e sistemit kapitalist, një zhvendosje nga kapitalizmi aksionar, pra korporatës që punon për pronarët, drejt kapitalizmit të aktorëve, korporatës që balancon më mirë interesat si të pronarëve, ashtu dhe të punëtorëve, mjedisit, komunitetit dhe shoqërisë në tërësi. Fatkeqësisht, siç e thotë me të drejtë znj. Leskaj në libër, ideologjitet e majta dhe të djathta në Shqipëri nuk kanë pasur pasues konsekuentë nga asnjëri krah politik. Dhe ky nuk është një problem që lidhet me natyrën ortodokse të politikave të

tranzicionit, të cilat mund të kuptohen për dekadën e parë të viteve '90, por janë të pajustificueshme më vonë, dhe siç e thotë autorja, janë pjesë e pragmatizmit elektoral. Në veçanti, sot kur në të gjithë botën ka nisur një debat global për një reformim të sistemit kapitalist, për një ribalancim më të mirë të sistemit, që të punojë edhe në mbrojtje të punëtorëve po aq sa dhe të sipërmarrësve, tema e modelit të ri ekonomik në Shqipëri shihet si një çështje thjesht teknike, se nga do të gjenerohet rritja ekonomike; si një debat pozitivist dhe jonormativ.

Zhvillimet sociale dhe demografike janë dhe mbyllja e librit. Që të dyja këto tema vijnë në një kontekst shqetësues për problemet që ato krijojnë në aspektin ekonomik dhe social në vitet që do të vijnë. Kjo temë, të cilën autorja e zhvendos pas në kohë, që në vitet '70, me raportin e famshëm të Klubit të Romës dhe paqëndrueshmërinë e modelit ekonomik përballë presioneve demografike, sot vjen në një trajtë tjetër; atë të një popullsie të plakur dhe rënie të lindshmërisë, të cilat do të prodhojnë sfida të vërteta serioze për vendet që do të ndikohen. Këtu bën pjesë dhe Shqipëria, ku vijat e grafikut të raportit midis fashës së popullsisë së re dhe asaj të plakur do të priten duke filluar nga viti 2023. Për pasojë, tregu i punës dhe të gjitha tregjet e tjera do të ndikohen në një mënyrë të thellë dhe do të sjellin pasoja gjithnjë e më të forta në shoqëri.

Znj. Leskaj përmes këtij libri, me këtë larmi temash dhe sfidash, jep një kontribut të rëndësishëm. Duke qenë edhe një rrugëtim në ato se çfarë ka ndodhur në këto tri dekada tranzicioni, libri ka një vlerë të shtuar edhe si një libër reference për studiuesit e këtyre fushave. Libri ka përfituar gjithashtu jo vetëm nga dijet dhe angazhimet politike të autores, por dhe nga pasuria e eksperiencave personale, duke e bërë atë një libër të shkruar përgjatë gjithë kësaj kohe dhe të pasuruar përmes një morie episodesh interesante.

*Selami Xhepa*  
*President, Universiteti Europian i Tiranës*



## HYRJE

Valentina Leskaj ka pasur gjithnjë një ide të qartë rreth politikës. Kur, gati një vit më parë, u takuam për herë të parë në kafenenë e Universitetit European të Tiranës për të folur për këtë libër, do të kuptoja se përveçse një ide, politika për të ishte një ndjenjë, pikërisht atë që të jep një qenie e gjallë, format e saj, shikimi i saj. Ekuilibri që ajo kërkonte të gjente mes saj dhe historisë, apo artikulimeve të përditshme politike, shpesh ishte mahnitës. Pothuajse në të gjitha takimet tona, harta e koncepteve mbi politikën zgjerohej, po aq sa edhe pasioni i saj drejt analizës.

Kjo grua, që ecte lehtë, me portretin e një zonje që tregon prirjet e saj të thella, dinte të linte gjithnjë një dritare hapur pas çdo diskutimi. Politika duhet të ishte një lëvizje e lirë, për të përparuar nga pengesat, pasi forca lind nga kundërshtimi.

Politika peshonte aq shumë në shpirtin e saj, sa edhe vetë vendi. Kjo ishte një ndjesi që unë kisha pas çdo bisede. Ajo vepron në përputhje me ndërgjegjen dhe ndjenjën për drejtësi, duke u përulur vetëm përpara logjikës.

E ardhur në politikë nga një karrierë në shoqërinë civile, më herët Leskaj ka qenë kryeredaktore e revistës “Shqiptarja e re”, pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, politika dukej se ishte destini i saj. Çdo artikulum, që ajo kishte bërë më parë, kishte qenë një tjetër formë e reagimit politik. Vetë karriera që ajo pati në radhët e Partisë Socialiste, ekuilibri që ajo arriti të gjente në një mjedis, shpesh të nderë, tregojnë maturinë e një politikaneje të konsoliduar.

Ndoshta se për të, fillimisht politika ishte vetë njeriu, fytyra të dashura, që luhaten nga një kohë në tjetrën, duke sjellë aromat e familjes, që përzënë mjegulla, dhe përhapin dritën para vështrimit të saj.

Emocionet mbeten gjithnjë diku të pashfaqura, por në artikulet që ajo bën, ti ndien forcën e tyre. Më pas, nga një bisedë në tjetrën, do të konfigurohet e plotë te ju ideja, se gjithë rrugëtimi i saj në jetë dhe të gjitha vokacionet e qëndrimeve të njohura, si çështja e gruas, ajo e shoqërisë civile, apo e të drejtave të njeriut, janë reagime që dalin nga brenda, gati-gati si misione të përhershme.

Ky libër-bisedash nxjerr në horizont pjesën më të qenësishme të personalitetit të saj politik dhe intelektual, por, në të njëjtën kohë, ngre për herë të parë pyetje që politika ende nuk i ka konsumuar brenda saj. Leskaj gjeneron ide në çdo artikulum dhe ndoshta kjo është një nga vlerat e rralla të këtij botimi.

Si autore kam qenë gjithnjë e tërhequr për të lexuar më shumë analiza mbi feminizmin. Nga Virginia Woolf te Simone de Beauvoir apo Margaret Atwood, kanë



feksur tek unë tablo ngjarjesh, që e bëjnë të plotë rrugën e mundimshme që gruas i është dashur të përshkruajë në histori. Shpesh, portreti i Rebecca Walker-it më kujton se feminizmi është integrimi i një ideologjie të barazisë dhe fuqizimit të gruas në fibrën e jetës, për të kuptuar strukturat e pushtetit, me qëllim, sfidimin e tyre. Kur disa kohë më parë, në një librari në Nju-Jork, do të hasja librin e saj “Tregimi i së vërtetës dhe ndryshimi i fytyrës së feminizmit”, botuar diku në vitin 1996, i ribotuar nën një tjetër kopertinë në vitin 2019, do të mendoja se feminizmi është ende i pranishëm te ne.

Ndaj, ky dialog me Leskajn, një grua që ka punuar për të drejtat e njeriut, nuk mund të niste ndryshe, pasi, ashtu si shumë historianë perëndimorë ende besojnë, çështjet e të drejtave lidhen me feminizmin. Për herë të parë, ky dialog hap dritë në rrugën e gjatë të feminizmit botëror, nën këndvështrimin e një gruaje që ka përshkruar të njëjtën rrugë, por në kohë e sisteme të ndryshme, për të sjellë një analizë bashkëkohore të asaj çfarë feminizmi përfaqëson. Ashtu si Walker, edhe Leskaj tregon të vërtetën e saj, për gra e lëvizje, të cilat deri vite më parë kanë qenë pothuajse të padukshme në mjegullën e historisë dhe ato janë feministet e para shqiptare.

Gjuha e urrejtjes dhe kultura politike, dy binome të lidhura fort me njëra-tjetrën, vijnë në një analizë, ndoshta për herë të parë, në diskursin publik shqiptar.

Leskaj është pararojë edhe në çështje të tjera, si ajo e popullsisë, artikuluar që në vitin 1992, kohë kur drejtonte Qendrën për Popullsinë dhe Zhvillimin, apo më vonë,

kur drejtonte Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, duke kërkuar vëmendjen e duhur ndaj një problemi serioz dhe shumë kompleks, referuar statistikave. Artikulimet e saj për këtë çështje e çojnë mendimin shqip në sferën e diskutimeve bashkëkohore për popullsinë, të cilat, pas pandemisë së COVID-19, kanë zënë faqet kryesore të gazetave botërore.

Nuk do të doja të zgjatesha më tepër në rrëfime, që autorja i shtjellon aq profesionalisht në faqet e tjera të këtij libri, por do të doja të ndaja ndjesi bisedash të pashkruara, të një gruaje që jeton me politikën. Teksa përgatiteshim për këtë libër, ajo nxori nga arkivat qindra bisedime të ndryshme që kishte bërë gjatë kohës kur ishte aktive në politikë, fjalime të mbajtura në parlament, letra të shkruara nga personalitete të shekullit XXI, shënime që vetë i kishte hedhur dhe fotografi. Çdo njëra prej tyre, nga ato ndoshta më të parëndësishmet e deri tek ato më thelbësoret, nuk e fshihte seriozitetin me të cilin ishte përgatitur. Ndoshta, me intuitën e një gazetareje të hershme, ajo e dinte se nëse shkruan diçka, do të mbetet përjetë dhe se politika, ndonjëherë, është thjesht në letër.

Por, sërish, ka diçka që i dallonte fjalimet e Leskajt dhe atëherë kur ato mund të ishin bërë nxitur nga një seancë e papritur, apo një ngjarje, e cila mund të provokonte reagim. Është pikërisht ekuilibri për të shmangur ashpërsinë me një raport gati-gati të kulluar me gjuhën, duke treguar se lidhja me gjuhën është tepër e qenësishme në një raport dhe se politika është gjuhë. Kjo aftësi për të kuptuar këtë element kaq të padukshëm në diskursin publik, por që

dominon të gjithë karrierën e saj politike, e ka veshur imazhin e saj publik pikërisht me një kristalinë që ta jep vetëm gjuha.

Gjuha, si një formë komunikimi, të shtyn drejt hapësirave të reja, të cilat i konfigurjnë qëndrimet e saj.

Leskaj udhëton përmes rrëfimeve në këtë libër në mijëvjeçarin e ri, pasi qëllimi i një analize nuk është vetëm të konfirmojë, por edhe të parashikojë. Idetë e saj enden në shtresëzime të reja sociale, kulturore e politike, duke ofruar për politologët, apo studiuesit e çështjeve ekonomike sociale, një nga leksionet më të vlefshme të këtij fillimshekulli.

*Alda Bardhyli*



## GRATË, NJË HISTORI E SHKURTËR E FEMINIZMIT

**“Ç’mund të presë shoqëria nga një krijesë e nënshtruar e skllavërisë?! Ç’mund të shpresojë nga një qenie ‘hije’, përballë supremacisë mashkullore? Ç’mund të presë femra, viktimë e këtij realiteti? Ajo e di se është e tillë; femër...”**

**Rreshtat e mësipërm janë shkëputur nga një shkrim i Selfixhe Ciut, shkruar në vitin 1936. Kanë qenë një plejadë grash tepër interesante në Shqipërinë e atyre viteve, që krijuan një identitet të tyrin në shtypin e kohës, mes të cilave dhe Ollga Plumbi që ju keni pasur rastin ta njihni e të shkruani për të... Ciu flet për shtigje të mbyllura, të cilat gruaja duket se ende përpiqet t’i hapë sot. A është arritur kjo?**

Natyrisht, flitet për kohë të ndryshme e të largëta dhe qysh nga ato kohë, kur shtigjet ishin të mbyllura për gratë, kanë rrjedhur shumë ujëra. Ajo që Selfixhe Ciu Broja ka shkruar, është realisht një sintezë e situatës së gruas në ato vite. Një sintezë që përmbledh gjithë çka ishte gruaja në shoqëri po edhe në familje, një qenie pa zë. Këto gra si Selfixhe Ciu, Ollga Plumbi, Musine

Kokalari, Mila Vangjeli etj., u bënë në njëfarë mënyre zëri i të pazëshmeve. Në fakt atë kohë kishte pak zëra grash, dhe ato pak zëra vinin kryesisht nga familje me traditë patriotike, por dhe me kulturë perëndimore; shumica e tyre ishin të shkolluara jashtë vendit dhe ishin të ndërgjegjësuara jo vetëm për situatën e vendit, por edhe për nevojën e angazhimit intelektual e qytetar. Këtë sens qytetarie e kurajeje e dëshmuuan me çfarë mundën.

E kam fjalën për ato gra që i përmenda më lart e të tjera që, edhe pse ishin si ata drurët e rrallë, guxuan të kishin një zë në shtypin e kohës, disa prej tyre zgjodhën nismën për arsimimin e grave si rruga më e mirë për fuqizimin e grave dhe vajzave, çka u jepte mundësi të kishin një zë për të drejtat e tyre. Ato zonja kishin kuptuar se edukimi është kyç për të drejtat e gruas e për të ardhmen e vendit, ndaj dhe u investuan me gjithë mundësitë e tyre në këtë sfidë të kohës.

Selfixhe Ciu Broja, Ollga Plumbi, Musine Kokalari, Urani Rumbo, Mila Vangjeli, kanë qenë më të njohurat për shkak të rolit dhe të pranisë së tyre në shtypin e kohës, po janë edhe të tjera gra, edhe pse të pakta, që me rolin e tyre kanë qenë protagoniste për çështjen e gruas me kauzat e tyre për edukimin e grave dhe vajzave, për inkurajimin dhe mbështetjen e arsimit në Shqipëri. Ishin motrat Qiriazhi, që kontribuan për hapjen e shkollës së parë për vajza në Korçë, qysh në vitin 1891 e më pas Urani Rumbo, që luftoi kundër analfabetizmit të grave, të cilin e quante arsye kryesore të prapambetjes së tyre. Në vitin 1920 Urania hapi shkollën e parë për vajza në

Gjirokastër. Ndërkohë që ka pasur edhe burra që kanë treguar angazhimin e tyre për çështjen e gruas në atë kohë. Ishin nga ata intelektualë e patriotë me mendje të hapur, siç ishin Frashërlinjtë, që e kuptonin se shoqëria nuk mund të ecte përpara nëse gjysma e saj është e shtypur dhe e prapambetur.

Rilindësi i shquar, Naim Frashëri, ishte një nga ata që nxiste përparimin e gruas, që vlerësoi shumë gjestin e Sevasti Qiriazit për hapjen e shkollës për vajza, së cilës i shkruan: “Motër, punë më të mirë dhe më të vyer nuk mund të bësh për Shqipërinë sesa vendimi që keni marrë për emancipimin e grave”.

Mithat Frashëri ishte gjithashtu një nga ata intelektualë të kohës, që qysh në vitin 1924, duke folur për problemet e vendit e për prapambetjen e gruas, ka shkruar se në Shqipëria ka nevojë për një organizatë grash, që do t’u jepte atyre një zë e një mundësi për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për t’u zhvilluar.

Kjo tregon se edhe në Shqipëri, qysh herët, nisi të flitet për çështjen e gruas, madje edhe diskutimi për votën është bërë qysh në vitin 1920, por bëhet fjalë më shumë për zëra që vinin nga shtresa elitare, siç ishin edhe zonjat që përmenda më lart, apo rilindës e intelektualë të tjerë edhe pse të rrallë. Megjithatë, ende nuk mund të bëhej fjalë për një lëvizje mirëfilli feministe, si ndodhi në vende të tjera europiane dhe në SHBA.

Gjithsesi edhe në botë lëvizja feministe, në kuptimin e plotë të një lëvizjeje të gjerë, ka nisur pak më vonë, po

shumë më herët sesa te ne. Ajo më e hershmja, që nisi nga gra të shtresës së lartë, ishte e orientuar kryesisht në çështjen e votës dhe të pjesëmarrjes së gruas në politikë, më vonë u zgjerua edhe me kërkesa të tjera, për të arritur në lëvizjet e viteve '60 për të drejtat dhe liritë njerëzore, pjesë e së cilës ishte dhe ajo që konsiderohet si vala e tretë e feminizmit.

**Në Shqipëri, asokohe, Ollga Plumbi ishte e para që ka folur për feminizmin si lëvizje, në shtypin e kohës me artikullin: “Feminizmi dhe shoqëria jonë” ...?**

Pa dyshim, të gjitha gratë, që përmenda më lart, patën një rëndësi të madhe për çështjen e gruas, sepse në qëndrimin e tyre nuk ishte vetëm shprehja e një opinioni, i cili ishte shumë i rëndësishëm sidomos për kohën, po si intelektuale të angazhuara ato ofruan modelin e gruas së zëshme, të gatshme për të marrë përgjegjësi e për të sakrifikuar për kauzën e saj dhe më shumë se kaq, ato ishin zëra me peshë edhe për interesat e mëdha të vendit, edhe pse e dinin koston që po merrnin përsipër. Kjo nuk ishte vetëm kurajë, ishte dije, kulturë e sakrificë gjithashtu. Ato kishin një sjellje e një sharm që i dallonte nga gratë e tjera, në komunikim e në gjithë qenien e tyre. Më dukej se kishin gjetur pikën e ekuilibrit, që i ndihmonte të ruanin sqimën, kulturën në sjelljen e tyre



dhe që pa dyshim i bënte të ndryshme nga pjesa tjetër e shoqërisë, po ndërkohë ruanin edhe thjeshtësinë, mirësinë, marrëdhënien njerëzore dhe forcën gjithashtu.

Kisha pasur rast të takoja disa gra të kësaj sere, që përgjithësisht kishin studiuar jashtë shtetit e përveç klasës e sqimës së familjeve nga vinin, reflektonin edhe kulturën e shkollave ku kishin studiuar. Ato ishin ndryshe, në fakt bënë diferencë, një nga këto ishte Ollga Plumbi.

Këtë përshtypje më ka lënë Ollga Plumbi, nga të rrallat gra gazetare të viteve 1930, gruaja antifashiste, ish-presidentja e parë e Grave të Shqipërisë pas çlirimit të vendit, post që nuk i zgjati shumë, ashtu si për shumë intelektualë të tjerë, që nuk e patën të lehtë ose nuk pranuan të konformoheshin me çfarë po ndodhte atë kohë.

**Ju keni pasur fatin ta njihni Ollgën dhe keni shkruar edhe në shtyp për të. Si e kujtoni takimin me këtë grua?**

Isha shumë e re kur e takova për herë të parë në shtëpinë e saj në rrugën e “Kavajës”. Pashë një grua flokëbardhë, të paqtë, me sy të zgjuar e që kishte një sjellje të kujdesshme, një lloj vetëpërmbytje. Nuk e di nëse kishte qenë gjithmonë kështu e kujdesshme, apo nëse ia kishin imponuar rrethanat e kohës, për shkak të goditjeve që kishte marrë. Për mua kjo nuk mund të

ishte karakteriale, nuk mund të kishte qenë kështu, një grua që nuk kishte pasur drojë e kishte bërë emër qysh në vitet '30, e as më pas kur u bë ndër të parat gra që u rreshtuan krah burrave në luftën antifashiste për çlirimin e vendit. Në fakt për këtë kontribut ajo u zgjodh edhe anëtare e Këshillit Antifashist, madje edhe anëtare e kryesisë së tij, ndërsa pas çlirimit të vendit në zgjedhjet e vitit 1945, u zgjodh edhe Deputete e Kuvendit Popullor, me një rezultat shumë të lartë në procesin e votimit. Në ato zgjedhje, Ollga Plumbi ishte deputetja e dytë më e votuar, pas Enver Hoxhës.

Po kjo nuk zgjati shumë. Shpejt ajo u hoq nga postet e u mënjanua nga politika, duke u mbyllur në shtëpi edhe pse ishte ndër të rrallat gra të angazhuara të asaj kohe. Ishte nga të rrallat gra që kish pasur një zë për të drejtat e grave qysh në vitet '30, kur ajo ishte e para që foli për çështjen e feminizmit në Shqipëri me artikullin “Feminizmi dhe shoqëria jonë”, në të cilin trajton situatën e grave në Shqipëri, parë nga një perspektivë feministe dhe nevoja imediate për ndryshim. Ndërkohë që në vitin 1936, në një artikull të botuar në revistën “Bota e re”, për çështjen e gruas Ollga shkruante se: “akoma jemi shumë prapa në fitimin e të drejtave njerëzore” duke u bërë nga të parat, që e sheh çështjen e gruas si të drejta njerëzore.

Në fakt Ollga ishte gruaja aktive në shtypin përparimtar të kohës, sidomos në vitet 1930 e në vijim në botimin e revistës “Bota e Re” bashkë me Migjenin

e Selim Shpuzën, te revistat “Rilindja” e “Përpyekja shqiptare”, te “Vatra” në vitin 1940, e më pas në revistën “Gruaja shqiptare” me pseudonimin Zita, ku kontribuoi jo vetëm me shkrimet e saj, por edhe për krijimin dhe mbajtjen e vetë revistës. Idetë e saj, sidomos për çështjen e përparimit të vendit, përfshirë çështje të lirive dhe të të drejtave të njeriut, për çështjen e gruas dhe të familjes në përgjithësi, ishin shumë të përparuara për kohën. “Vajzat le të shkojnë të bëjnë dashuri, vëllezërit le ta kuptojnë se është normale”, shkruante Ollga Plumbi në ato vite duke përballuar e vetme mentalitetin e kohës, por edhe një jetë shumë të vështirë personale, pas humbjes së të shoqit. Ishte një kurajë e madhe të përballje një opinion pothuaj obskurantist për çështjet e të drejtave të grave, e sidomos ato që lidhen me lirinë për të bërë zgjedhjen e tyre në jetën personale, madje kjo shpesh nuk është e lehtë edhe sot pas afro 90 vjetësh.

Po me Ollga Plumbin ishte ndryshe. Në fakt, Ollga nuk ishte një rastësi, përveçse vinte nga një familje intelektuale e patriote, ajo u martua në një derë gjithashtu të madhe, një familje patriote e përparimtare e kohës. Vinte nga dy prindër të ditur, babai i saj Zahari Leka, ishte një mjek i shquar, që kishte studiuar në Francë, kurse e ëma, Polikseni, kishte studiuar në Athinë në kolegjin e njohur “Arsaqion”, i cili mban emrin e një përmetari shumë të njohur. Në kolegjin “Arsaqion” studioi fillimisht edhe Ollga, ku u diplomua për pedagogji.

Ndërkohë ajo hyri në një familje gjithashtu të njohur e me kontribute edhe për çështjen kombëtare. Vjehri i saj, Mihal Plumbi, ishte një nga anëtarët themelues të “Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip” në Stamboll, të drejtuar nga Sami Frashëri, ndërkohë që bashkëshorti i saj, Pirua, bënte pjesë në elitën e përmetarëve intelektualë të kohës, po u nda shpejt nga jeta duke e lënë Ollgën shumë të re, rreth 30 vjeçe, me djalin e saj të vetëm Emilin. Gjithsesi Ollga ishte gruaja kurajoze që, pas vdekjes së bashkëshortit në vitin 1930, mori djalin e saj dhe u largua nga Përmeti, edhe pse ishte një vendim jo i lehtë për një grua të ve, në atë kohë. Po ajo kishte inteligjencën dhe kurajën për të bërë zgjedhjen e saj. Zgjodhi të jetonte në Korçë dhe jo rastësisht, Korça ishte zgjedhja që e motivonte profesionalisht e kulturalisht, ishte një dilemë që e kishte pasur me vite. Edhe pse ishte qyteti i Frashërllinjve, qytet i njerëzve të mirë, me intelektualë të njohur, Përmeti ishte i vogël për Ollgën. Në fakt, dukej sikur i rrinte ngushtë, sidomos një gruaje të angazhuar si ajo. Ajo e dinte se Korça i krijonte të tjera mundësi, një qytet i madh jo thjesht numerikisht po sidomos me kulturën e saj, me shkollën e parë shqipe, me shtypin e kohës, me Liceun Francez e me kolegjin amerikan “Kenedi”, ku ajo u punësua e dha mësim deri në mbylljen e tij. Pas mbylljes së kolegjit “Kenedi”, Ollga u kthye në Tiranë ku vijoi angazhimin e saj me shkrime e përkthime dhe aktivitetin antifashist si një organizatore për Këshillin Antifashist të Gruas për Tiranën dhe më pas si kryetare e këtij Këshilli.

Për t'u kthyer te përshtypjet që më ka lënë vizita në shtëpinë e saj kujtoj se ishte pasdite dhe derën e shtëpisë ma hapi djali i saj, Emil Plumbi, një inxhinier i talentuar, i cili ka vënë bazat teknike të “Radio Tiranës” qysh në hapat e parë të saj, po edhe më vonë në çdo fazë të zhvillimit të teknologjisë së kohës.

Ollga më priti te hyrja e vilës. Edhe pse ishte takimi i parë me të, lexohej menjëherë që ishte një grua e kulturuar, çka reflektohej në të gjithë qenien e saj: në komunikim, në gjuhën e pasur e të përpunuar, në atë që quhet *body language*, gjuha e trupit. Nga çfarë ajo përfaqësonte si personalitet, Ollga të dukej e largët sidomos për një vajzë të re siç isha unë në atë kohë, po njëherësh të dukej e afërt nga marrëdhënia që krijonte me atë që kishte përballë, shenjë kjo e njerëzve të kulturuar. Kisha përballë gruan, që u angazhua të japë kontribut kur vendi kishte nevojë më shumë se kurrë, duke u bërë zëri i të pazëshmëve, luftëtaren për të drejtat e njeriut, po edhe për çështje të tjera politike, që kishin të bënin me fatet e vendit. Si gazetare, si njeri i angazhuar, madje edhe si pjesëmarrëse aktive në luftën antifashiste dhe duke marrë me vete edhe fëmijën e vetëm, Emilin 19-vjeçar, Ollga la gjurmë kudo që shërbeu.

Pasi e hoqën si presidente të Gruas, ku qëndroi vetëm dy vjet, Ollga Plumbi, një grua mjaft e ditur, mbeti pa punë për një kohë, e më pas punoi si shefe e marrëdhënieve me jashtë në Bibliotekën Kombëtare, detyrë që i erdhi

edhe falë gjuhëve të huaja që ajo zotëronte. Më pas e nxorën shpejt në pension. Në shtëpi iu kthye librave të saj të shumtë, në disa gjuhë; e ku mua më rrinin sytë gjatë gjithë kohës që isha në shtëpinë e saj. Më duket se veshët i kisha tek Ollga dhe sytë më shkonin te biblioteka aq e pasur e në disa gjuhë të huaja.

Isha e re atëherë, ndoshta edhe për të gjykuar çka Ollga përfaqësonte, po edhe sepse shumë pak kisha dëgjuar për të, edhe më pak kisha lexuar nga çfarë ajo kishte shkruar e bërë e kjo ngaqë ishte lënë në harresë. Kisha kërshërinë e madhe për ta takuar gruan që kishte qenë e para presidente e Grave në Shqipëri, dhe gazetare qysh në vitet '30, edhe pse nuk përmendej asnjëherë, madje as në përvjetorë të organizatës që kishte drejtuar, kjo ma shtonte edhe më shumë interesin. Në fakt doja të shkruaja një shkrim për të, në revistën “Shqiptarja e re”, edhe pse nuk isha e sigurt sesi do të pritej, gjithsesi doja të shkruaja për gruan që jetonte në shtëpinë e rrugës së “Kavajës”, mbuluar nga heshtja. Kuptohej që shfaqjen e saj në publik e bënë të vështirë kufizimet e kohës. Ishte një arsye madhore, që e bëri të mbyllë gojën e të lërë penën, gruan që dikur kishte sfiduar kohën.

E bënte këtë sakrificë për vete, një grua e atij kalibri?  
Natyrisht që jo. Kurrë nuk e kam besuar.

Ajo nuk kishte pasur drojë, as kur shkruante kundër mentalitetit të kohës në vitet '30, as kur luftonte si

antifashiste, në fakt nga ai takim kuptova që ishte e shqetësuar për familjen, edhe pse nuk e tha. Që ishte kohë e vështirë për të, kjo kuptohej lehtë nga vetëpërmbajtja e saj, që edhe gjatë bisedës më shumë të krijonte përshtypjen e autocensurës. Ne që punonim në ato pak medie atë kohë, e kuptonim shumë mirë këtë gjë, e jetonim përditë.

Ollga kishte një kulturë të gjerë edhe pse ishte modeste, kjo ishte përshtypja që më la e që më pas do ta quaja modesti në kohën e harbutërisë. Forca e personalitetit të saj qëndronte te dija, te qetësia me të cilën i përballonte gjërat, edhe ato më të vështirat. Ajo besonte te forca e gruas për të ndryshuar shoqërinë, por thoshte se gratë duhet të kenë lirinë për të vendosur, e sidomos për t'u arsimuar "se shoqëria nuk mund të zhvillohet pa dije". Në fakt Ollga ishte një grua e angazhuar, që kishte dije të thella në disa fusha, ishte e përmendur për studimet e saj pedagogjike, ndërkohë që më ka befasuar me njohuritë që kishte në fushën e zhvillimit human, madje më ka mbetur në mendje ajo që më ka thënë për jetëgjatësinë. Ajo thoshte se njeriu potencialisht mund të jetojë deri në shtatëfishin e zhvillimit të vet duke e marrë zhvillimin deri në 20 vjeç dhe jeta mesatare do të vijë duke u rritur progresivisht me zhvillimin e shoqërisë.

U ndjeva shumë mirë në atë vizitë, ishte një bisedë shumë e vyer për mua që më ka lënë gjurmë.

**Emancipim nuk do të thotë vetëm të marrësh në mbrojtje, por edhe të kritikosh, shkruante Selfixhe Ciu në vitin 1936. “Unë u ndërgjegjësova, - shkruan ajo, - se të jesh femër nuk është fatkeqësi. Dhe kjo gjë duhet shpërndarë në familje dhe shoqëri...”**

**Libri i saj me kujtime “Tallazet e jetës” është një dëshmi e qëndresës së grave në ato vite të vështira. E përfshirë në Luftën Antifashiste ajo u përjashtua nga partia në vitin 1945 bashkë me të shoqin, dramaturgun Xhemal Broja. Fati i saj nuk qe i ndryshëm nga ai i grave të tjera, të cilat përbënin një zë opozitar.**

Selfixhe Ciu Broja, ishte gjithashtu, njëra prej gazetarëve dhe poetëve të para të viteve '30, nga të rrallat gra intelektuale që kishte studiuar në Firence e më pas në Grenoble në Francë e që pas lufte, pati një jetë shumë më të vështirë pasi përjetoi kalvarin e dënimeve dhe internimeve.

Selfixheja dhe Ollga ishin mike qysh në vitet '30, i bashkonte jo vetëm lidhja miqësore e kultura, sëra që ato përfaqësonin, por, mbi të gjitha, kauzat te të cilat ishin angazhuar, dhe jo vetëm ajo e grave. Ato i bashkonte dhe i motivonte besimi për një Shqipëri tjetër, atë të shoqërive që ato kishin parë jo si vizitore, po si gra që e kishin përjetuar diferencën. Selfixheja thotë se: “Me Ollgën ndanim pikëpamjet lidhur me emancipimin e gruas, të cilat na përputheshin”. Ajo e quan Ollgën “një militante për çlirimin e gruas dhe ndër luftëtaret e para që u rreshtuan në Luftën Çlirimtare”.



Me kalimin e viteve këto gra u bënë si ata drurët e rrallë, ato që ishin më me fat, mbetën në hije, të tjera u internuan, u burgosën, u ndanë dhunshëm nga njerëzit e tyre të dashur e nga të tjerë me të cilët ndanin pikëpamje e vlera të përbashkëta. Jam e keqardhur që ende flitet shumë pak për to, jam e keqardhur që në shkollat tona, ku futen lloj-lloj librash pa vlerë, në disa raste edhe me antivlera, flitet shumë pak për këto gra me kaq shumë vlera.

Po për t'u kthyer te pyetja juaj, nëse flasim për gratë sot, natyrisht që ka ende shumë probleme, ka edhe në vende më të zhvilluara, po natyrisht që do të flisja më shumë për shtigje të vështira, sesa për shtigje të mbyllura.

### **Lëvizjet feministe në Europë do të vinin vonë në vitet 60-70-të. A mund të flasim për një histori të feminizmit shqiptar?**

Nëse flasim për vitet 60-70-të, ato ishin vitet e shpërthimit të madh, po lëvizjet feministe në Europë kanë nisur shumë më herët e akoma më herët në Amerikë. Po nëse do të bënim një krahasim lidhur me feminizmin mes Shqipërisë dhe Europës natyrisht diferencat janë të thella, e jo vetëm kohore, por edhe në vetë konceptin për feminizmin, përmasën e përfshirjes së shoqërisë në një debat të tillë e për rrjedhojë edhe impaktin në jetën e grave. Lufta për të drejtat e grave, edhe në vende të zhvilluara, ka kaluar përmes betejave të vështira, kështu

është dashur një rrugë e gjatë për të arritur te feminizmi i viteve '60, që shënjuan ndryshimet e mëdha, edhe përndonjëherë këtu te ne flitet sikur feminizmi lindi në një ditë me diell, ndërkohë që ai ka kaluar nëpër disa faza. Ato që quhen *feminist waves* ose valët feministe, kanë nisur shumë më herët se viti 1960, e natyrisht shumë më herët sesa në Shqipëri, po secila fazë e feminizmit ka pasur veçoritë e saj.

Në fakt lëvizjet feministe janë ndarë kryesisht në katër faza, jo vetëm sipas kriterit të kohës kur kanë nisur, por sidomos sipas çështjeve që kanë përfshirë. Ajo që quhet vala e parë e feminizmit ka nisur kryesisht nga gra të shtresës së lartë, të cilat u angazhuan për të drejtën e votës dhe përfshirjen e grave në politikë në disa vende të Europës Perëndimore, e njohur në Angli si *Suffragism*, që lidhet me votën, po që ka qenë shtrirë edhe në vende të tjera. Ndërkohë që vala e dytë e feminizmit i zgjeroi kërkesat me çështje që kanë të bëjnë më shumë me pabarazitë sociale dhe kulturore, e përveçse kishte një përfshirje më të gjerë e më masive të grave, pati angazhim edhe të burrave, kryesisht intelektualë, po edhe të tjerë nga shtresat e mesme të shoqërisë. Në këtë valë u përfshi klasa e mesme dhe kryesisht lëvizjet e majta.

Në valën e tretë, feminizmi u shtri edhe në çështje të të drejtave ekonomike, në rritjen e rolit të gruas në vendimmarrje dhe medie, në të drejtat riprodhuese, të drejtën e abortit, atë të divorcit etj. Më vonë feminizmi u angazhua edhe në çështje të tjera, sidomos ato që

lidheshin me grupet e marginalizuara. Në fakt, Franca ka qenë një nga më të zëshmet e më përfshirëset në këtë periudhë. Po edhe pse Franca ka qenë nga më të hershmet në idetë e feminizmit, rezultatet ishin më të vonshme sesa në vendet e tjera, përfshirë edhe të drejtën e votës së grave, e cila në Francë u realizua në vitin 1945. Waelti-Walters, në studimet për feminizmin thotë se: “rrënjët e feminizmit modern gjenden në Francë” dhe kjo është e vërteta. Gjithsesi, Finlanda ishte vendi i parë sa i takon rezultatit në një kohë më të hershme, ku u zgjodhën gra deputete qysh në vitin 1907. Danimarka, gjithashtu, ishte një ndër vendet e para në Europë ku beteja për të drejtën e votës dhe zgjedhjen e grave, erdhi në formën e lëvizjes së mirëfilltë feministe, të organizuar fillimisht në një shoqatë, e cila u krijua qysh në vitin 1884 me një mbështetje të gjerë publike, dhe më pas vijuan edhe organizime të tjera. Këto lëvizje patën një ndikim sidomos për të drejtën e votës për gratë qysh në vitin 1908 për zgjedhjet bashkiake dhe, më pas, në vitin 1915 për zgjedhjet parlamentare. Në vitin 1918 Danimarka kishte 12 gra deputete, ishte i vetmi vend që kishte këtë përfshirje të grave në parlament. Edhe pse e para grua kryebashkiake në Danimarkë u zgjodh vetëm në vitin 1950.

Po ajo që pati një ndikim të madh, jo vetëm brenda vendit, ishte rasti i Anglisë që nisi me kërkesat për votën. Lëvizja feministe në Angli pati si veçori jo vetëm jehonën ndërkombëtare, po ishte më e plotë pasi përfshiu qysh në fillim edhe kërkesat për punën, pagën dhe kushtet e

punës së grave, gjë që në vende të tjera erdhi pak më vonë. Ishte aktivistja e famshme për të drejtën e votës, Sylvia Pankhurst-i, me shoqet e saj si Ray Strachey, që u angazhuan fort, qysh në vitin 1906, për krijimin e një lëvizjeje që nisi me protestën për të drejtën e gruas për votën dhe shpejt Sylvia bashkë me të motrën dhe nënën e saj, krijuan një organizatë të grave, e cila u quajt WSPU, Unioni Social dhe Politik i Grave. Më pas rrugët e dy motrave u ndanë, po Sylvia i qëndroi besnike motivimit të saj në udhëheqjen e lëvizjes feministe dhe vijoi betejën për *Suffragism*.

Natyrisht, ishte një betejë e vështirë sidomos për kohën, po që pati një jehonë e ndikim të fortë brenda dhe jashtë vendit. Falë edhe kulturës e talentit të saj, kjo ishte hera e parë që çështja e të drejtave të grave mori një vëmendje të gjerë në opinionin publik, falë edhe një mënyre të komunikimit publik të paparë më parë, përmes përdorimit të posterave, fletëpalosjeve, banerave etj., që i shpërndanë në sheshet qendrore të Londrës e përtej saj. Në kushtet kur për një grua, ishte shumë e vështirë të ishte e pranishme në shtypin e kohës dhe dyfish e vështirë sidomos për çështje që kishin të bënin me të drejtat e gruas, Pankhurst-i me grupin e saj ia doli të krijonte një sensitiltet të lartë, qoftë edhe kundërshtues. Mendoj se e rëndësishme ishte që ato ia dolën të krijojnë një klimë që të flitej për të drejtën e votës së grave, madje edhe për probleme të tjera që lidheshin me pagën, me kushtet e punës së grave etj., duke i detyruar autoritetet publike dhe të tjerë kundërshtues të merreshin me çështjen. Lëvizja

arriti ta vinte çështjen e gruas në qendër të debatit, në vendin e saj, po ndërkohë ky sensibilitet i kapërceu kufijtë e Anglisë me atë që qysh prej asaj kohe quhet *Suffragism*.

Protagonizmi i Sylvia Pankhurst-it në fushën e të drejtave nuk ishte rastësi, ajo ishte ushqyer me këtë kauzë pasi dy prindërit e saj ishin aktivistë të shquar, ndër themeluesit e Partisë së Pavarur Laburiste, e cila u bë edhe mbështetësja kryesore për të drejtën e gruas për votën. Po si kudo, edhe në Angli lëvizja feministe nuk e pati të lehtë, ajo krijoi edhe reagime të ashpra nga kundërshtarët e saj dhe Sylvia Pankhurst e disa nga bashkëluftëtarët e saj, si Ray Strachey, paguan një çmim shumë të lartë; Sylvia është futur 15 herë në burg po kështu edhe bashkëluftëtarët e saj u burgosën disa herë. Natyrisht angazhimi dhe kuraja e tyre inspiroi gra në të gjithë botën, i hapi udhë lëvizjeve që sollën një ndryshim të madh për të drejtat e grave dhe të drejtat njerëzore.

Në Amerikë, gjithashtu, lëvizja e gruas ka qenë e hershme, në fakt gruaja e parë kandidate për presidente e SHBA-së, daton shumë herët, shumë kohë më parë se në Europë, edhe pse ende nuk ka arritur të zgjidhet një grua presidente, por edhe në mjaft vende të Europës ende nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Victoria Woodhull, një *stockbroker*, botuese gazete, kampione e reformave sociale, ishte e para grua që shpalli kandidaturën e saj për presidente të SHBA-së për zgjedhjet e vitit 1872. E shpalli kandidaturën në gazetën “New York Herald”, qysh

në 2 prill 1870, pra 50 vjet përpara se gratë në SHBA, të fitonin të drejtën e votës. Më pas, të tjera gra kanë shpallur kandidaturën në SHBA, për të garuar po nuk ka qenë e mundur, kështu edhe Hillari Klinton, kandidatja më e suksesshme grua, për të cilën pati pritshmëri shumë të lartë, e që në fakt fitoi votën popullore, nuk arriti të bëhej presidente e SHBA-së, pasi humbi votën e kolegjit elektoral në zgjedhjet e vitit 2016. Por lëvizjet për të drejta e grave në Amerikë janë më të hershme krahasuar edhe me Europën; Elizabeth Stanton-i është quajtur *suffragette*, sepse ajo bashkë me Lucretia Mott-in, organizuan konventën e parë për të drejta e grave qysh në vitin 1848 në Nju-Jork, ose siç është quajtur Konventa e Senekës, e cila doli me kërkesa për të drejta të barabarta mes grave dhe burrave, si edhe të drejtën e votës për gratë. Madje lëvizja e *suffragette*-ave në Amerikë daton shumë më përpara se në Angli dhe konventa e vitit 1948 konsiderohet nga historianët si lëvizja që i dha formë valës së parë të feminizmit.

**Eleanor Rusvelti, një grua mjaft interesante, e lidhi progresin e gruas me konceptin e së bukurës, duke kërkuar përhapjen e saj... Çfarë mendoni për këtë qasje?**

Nuk besoj shumë në interpretimet e ndryshme që i janë bërë kësaj shprehje të saj. Në fakt, ajo flet jo për bukurinë fizike, por për atë të ëndrrave që lidheshin me një shoqëri të drejtë e të mundësive të barabarta. Eleanor

Rusveldi ishte një luftëtare e paepur, një inspiruese për të drejtat njerëzore. “E ardhmja iu përket atyre që besojnë në bukurinë e ëndrrave të tyre”, shprehej Rusveldi. Bashkëshortja e presidentit Rusvelt, ka qenë një nga feministet më me peshë në SHBA. Është një nga zonjat e para të Shtëpisë së Bardhë, e cila bëri diferencën dhe solli ndryshimin duke thyer traditën e pozicionit të zonjës së parë të SHBA-së, ishte një luftëtare për të drejtat civile e sidomos për të drejtat e grave dhe ato të popullsisë afroamerikane e aziatikoamerikane në një kohë kur kjo nuk ishte e lehtë. Eleanor Rusvelt njihet si një zë i fortë dhe mjaft e pranishme në medie, ajo ishte kolumniste në disa gazeta e revista të kohës, ishte e pranishme në shumë evente publike, që atë kohë nuk ishin në mandatin dhe modelin e një zonje të parë. Nuk ka thyer vetëm tabu, që lidhen me rolin e zonjës së parë, Eleanor është e njohur për qëndrimet e saj të pavarura, ndonjëherë të ndryshme edhe nga ato të bashkëshortit president, çka nuk ishte një gjë e lehtë në Amerikën e atyre viteve. Ajo ishte mjaft aktive në politikën e vendit dhe në atë ndërkombëtare, sidomos në fushën e të drejtave njerëzore, angazhim që e vijoi edhe pas humbjes së të shoqit, presidentit Rusvelt, kur u bë dhe e para kryetare e Komisionit të OKB-së për të drejtat e njeriut duke luajtur një rol të rëndësishëm me kontributin që dha për Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Më vonë Eleanor Rusveldi drejtoi Komisionin Presidential për Statusin e Gruas në kohën e presidentit Kenedi.

Gjithsesi për t'u kthyer në vitet '60, duhet thënë se janë ato që bënë shkundjen dhe kthesën e madhe, edhe pse natyrisht flitet për një kohë tjetër, krahasuar me valën e parë të feminizmit, drejt një bote më të hapur e më komunikuese me fillimet e shpërthimit të medieeve, jo vetëm brenda Kontinentit European po edhe përtej tij, sidomos në SHBA. Vitet '60 shënjuan ndryshimin e madh që shpesh është quajtur *counterculture*, veçanërisht në fushën e të drejtave civile, në normat sociale e ato kulturore me thyerjen ose zbutjen e shumë tabuve duke filluar nga veshja, muzika me Bob Dylan and Paul Simon, me festivalin e famshëm *Woodstock* të gushtit 1969, që zgjati tri ditë, dhe pa dyshim kjo ishte periudha që ka ndikuar edhe për ndryshimin e madh, si edhe në statusin dhe të drejtat e grave gjithashtu, sidomos për reforma legjislative dhe politika mbështetëse.

Natyrisht, gjithë këto ndryshime të mëdha, ishin të lidhura edhe me një kontekst të caktuar politik e social, që i parapriu ose që buroi nga këto tronditje të kohës. Në Amerikë ishte koha e Presidencës Kenedi, e përfaqësuar nga një frymë liberale dhe më pas ishte vrasja e tij në nëntor të vitit 1963 që tronditi Amerikën; ishte koha e Martin Luther King-ut, një lider i të drejtave civile në Amerikë dhe fjalimi i tij i famshëm "I have e Dream", si edhe vrasja e tij në vitin 1968 që patën gjithashtu një jehonë, e cila shkonte përtej Amerikës; ndërkohë ishte koha e luftës në Vietnam, me kundërshtitë si brenda dhe



jashtë Amerikës, por sidomos në Europë që nxiti një klimë protestash e reagimesh kundër luftës dhe për të drejtat e liritë civile.

Në Amerikë, por edhe në rajone të tjera, ngjarjet e viteve '60 krijuan klimën e favorshme për valën e dytë të feminizmit, ose siç është quajtur “Second Feminist Wave”, e cila u sanksionua edhe me akte zyrtare, që kanë mbetur në histori, siç ishte miratimi i Aktit të parë në llojin e vet, për të Drejtat Civile i miratuar në vitin 1964 në Amerikë, i cili ka qenë një pikë referimi për të drejtat civile dhe antidiskriminimin lidhur me racën, ngjyrën, fenë, gjininë etj. Ndërkohë që Akti për Pagë të Barabartë, i cili u miratua në vitin 1963, dhe Krijimi i Komisionit Presidencial për gratë, nga presidenti Kenedi, për mosdiskriminimin e grave në vendin e punës, për shkak të gjinisë, ishte shumë i rëndësishëm dhe krijoi bazën për kapërcimin e barrierave ligjore, që lidheshin me të drejtat dhe liritë e gruas në karrierën profesionale, dhe rolin e saj në shoqëri. Atë kohë këto akte patën një jehonë të madhe në shtypin e kohës. Këto akte shërbyen si nxitje për kërkesa e ndryshime të tjera brenda Amerikës, po ndërkohë inspiroi lëvizjet feministe edhe në vende të tjera të botës. Betty Friedan<sup>1</sup> me librin e saj *bestseller*, “Mistika Femërore”, që analizon dilemat e grave të shtresës së mesme, po dhe shumë botime të tjera të saj, pati një ndikim të ndjeshëm në çështjet e feminizmit jo vetëm në Amerikë po edhe përtej saj.

---

<sup>1</sup> Betty Friedan, *The Feminine Mystique*, SHBA, 1963.

Ndërkohë Franca kishte një traditë më të hershme në feminizëm, por ajo që ndodhi sidomos në vitet 1968-1969, me protestat e mëdha civile, me grevën e përgjithshme të Majit 1968, që përfshiu rininë universitare e miliona punëtorë të fabrikave, përveçse antiestablishment ishte një nxitje për ndryshim në norma sociale, kulturore, që shënuan një kthesë të rëndësishme në çështjet e të drejtave njerëzore dhe në ato të të drejtave të grave dhe, përgjithësisht, për një shoqëri më të hapur e pa tabu.

Vitet 1960 u shënjuan edhe në Angli, Gjermani, Holandë, Itali, vendet Nordike etj., për ndryshimet që sollën dhe për efektin e tyre në lëvizjen për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave gjithashtu.

Feminizmi, në ato vite, u kthye në një modë në shumë vende, po në fakt mendoj se në substancën e tij ky ndryshim i thellë, që jo rrallë autorë të ndryshëm me të drejtë e quajnë revolucion, nuk ishte çështje mode po një çështje themelore e të drejtave njerëzore, që bëri një ndryshim të madh jo vetëm në jetën e grave, në të drejtën e tyre për përfaqësim në vendimmarrje e akses në politikë, po edhe në të drejtën e tyre për punë e pagë të barabartë, në të drejtat e tjera ekonomike, sociale, shëndetësore, kulturore në shoqëri e familje. Nga ana tjetër mendoj se nuk ishin vetëm gratë, që përfituan nga këto të drejta, por besoj fort që kjo ndikoi në një politikë e ekonomi më të mirë, në një shoqëri më të drejtë, më humane e më cilësore, ku gratë që kanë një potencial të rëndësishëm mundën të kontribuojnë për zhvillimin e shoqërisë.

## **Të gjitha këto zhvillime ndodhën kur ne ishim brenda perdes së hekurt. A pati ndikim te ne?**

Unë besoj që po, edhe pse shumica e popullsisë as nuk e dinin çfarë ndodhte përtej perdes, po në disa raste, si edhe ky i viteve '60, politika e kohës nxirrte ndonjë nismë, ndonjë fjalim programatik apo ndonjë direktivë, pa dyshim edhe nën shqetësimin e asaj që ndodhte përtej nesh, por gjithnjë të ambalazhuar sipas nismave që vinin nga brenda e jo nga e vërteta, dhe kjo, sepse ajo çfarë ndodhte jashtë mureve shihej si rrezik që mund të depërtonte te ne.

Një pjesë e mirë e shoqërisë sonë feminizmin si koncept e konsideronte më tepër si shfaqje kapitaliste, si një deviancë borgjeze, madje edhe armiqësore, dhe jo vetëm në Shqipëri. Shihej si e tillë sidomos faza e parë e feminizmit, kjo edhe për shkak të kategorisë së njerëzve që u përfshinë në të, që ishin më shumë të shtresës së lartë, ndërkohë që në valën e dytë u përfshinë më shumë majtistë. Gjithsesi, mbështetur edhe në të dhëna të kohës, si rasti i Anglisë dhe krijimi i Aleancës Ndërkombëtare të *Sufragette*-ave e të tjera lëvizje feministe; në Danimarkë e në të tjera vende, lëvizjet feministe ishin të lidhura me lëvizjet majtiste, që shpesh u bënë burimi dhe mbështetja e tyre qysh në fazën e parë të lëvizjes, madje një pjesë e tyre buroi nga grupimet e majta. E majta ka qenë vazhdimisht

më e hapur dhe mbështetëse ndaj lëvizjeve për të drejtat e grave. Dua të sjell një deklaratë të ish-kryeministrit spanjoll, José Luis Zapatero, kur deklaronte se: “Unë jam feminist se jam socialist”. Përveç qëndrimeve të forta të mbajtura në shumë çështje të politikës ndërkombëtare si, për shembull, për luftën në Irak, Afganistan e të politikës së brendshme për Katalonjën, kryeministrit socialist, Zapateros, i njihen shumë reforma liberaliste në vend si dhe ato për të drejtat e njeriut, ku janë përfshirë ato të grave. Pas dy mandatesh si kryeministër, një vit përpara zgjedhjeve, ai deklaroi se nuk do të rikandidonte për një mandat tjetër, ky ishte një tjetër shënjim e diferencë që bënte.

Jo rastësisht, Europa udhëheq për sa i takon përfshirjes së grave në vendimmarrje të niveleve të larta, përfshirë numrin e grave kryetare të shtetit, gjë që ka të bëjë me nivelin e demokracisë së një vendi, edhe pse nuk mund të themi të njëjtën gjë për nivelin e parlamenteve. Gjithsesi, të dhënat e dhjetë viteve të fundit tregojnë se është krijuar një qëndrueshmëri sa i takon balancave gjinore në politikë e përgjithësisht në vendimmarrje, por sidomos për sa i takon të drejtave të tjera që lidhen me gruan, si në edukim, punësim e pagesë, në mbrojtjen sociale, në karrierën profesionale, në të drejta pronësie, në zgjedhje të lirë për familjen, më shumë liri e siguri për mëmësinë etj.

## **A mund të flasim për një histori të feminizmit shqiptar? Në sa faza do ta shihnit zhvillimin e feminizmit në shoqërinë shqiptare?**

Në rastin e Shqipërisë, çështja e feminizmit është pak më ndryshe dhe mund të shihet më shumë e lidhur me periudhat politike, po që vështirë t'i quash valë feminizmi. Gjithsesi, sot flitet për drejtësi e barazi gjinore dhe mendoj se edhe këtu ka një qasje tjetër më përfshirëse në çështjen e gruas. E vërteta është që shpesh feminizmi është parë si një qasje kundër jo pro, në kuptimin kundër *tjetrit*, të ndryshmit në gjini. Personalisht jam për një qasje proaktive për njohjen dhe respektimin e barazisë dhe drejtësisë gjinore, ku burrat nuk duhet të shihen si pjesë e problemit po si pjesë e zgjidhjes, dhe përvoja ka treguar se përfshirja e tyre, aty ku është realizuar, ka dhënë rezultat. Natyrisht jo të gjithë mendojnë kështu, po kjo është një çështje që ia vlen të diskutohet.

Nëse kthehemi te fazat e feminizmit dhe Shqipëria, në një vështrim të periudhave, mendoj se dy fazat e para nuk kanë qenë tipike me atë që quhet vala feministe (Feminist Waves).

Faza e parë, ajo e viteve '20-'30 më shumë sesa një lëvizje e organizuar feministe, kishte zëra individualë të angazhuar, që kryesisht përdornin shtypin e kohës për të ndikuar opinionin ose ndërmerrnin nisma individuale, si ato për arsimimin e vajzave, që janë përmendur edhe më lart, po nuk ishin të organizuara si lëvizje të mirëfillta

feministe, gjë që nuk ishte e lehtë në atë kohë. Gjithsesi, ai feminizëm i fshehur, sporadik kishte frymëzim perëndimor. Në kohën e monarkisë u bënë disa ndryshime lidhur me statusin e gruas, por këto ndryshime, si ndalimi i mbulimit (perçes) apo të tjera, ishin më shumë masa sesa një lëvizje me perspektivën e të drejtave të gruas. Gjithsesi disa ndryshime në Kodin Civil, që adresonin dhe regjimin pasuror në rastin e divorcit, një regjim pasuror jo të mbështetur mbi kanunin, i cili i jepte gruas të drejtën që pas divorcit të merrte “ tre grosh dhe... kallamoq”, po të mbështetur mbi bazën e ligjit, ishin të rëndësishme. Edhe pse këto ndryshime në Kodin Civil pothuaj nuk u zbatuan, edhe për shkak të rrethanave të kohës, kur veprimi i kanunit, që rregullonte marrëdhëniet e pronësisë ishte dominues, gjithsesi ishin një hap shumë i rëndësishëm drejt një kodi civil perëndimor, i cili në fakt ishte mbështetur në modelin e ligjit francez.

Në periudhën e komunizmit, feminizmi si term ishte pothuaj një tabu, e vetmja organizatë që u krijua kishte frymëzim kryesisht ideologjik komunist, vetë çështja e gruas ishte pjesë e ideologjisë. Gjithsesi e vërteta është se gjatë asaj periudhe, u bënë ndryshime të rëndësishme në statusin e gruas në disa fusha, por sidomos në arsimim, daljen e gruas nga shtëpia, punësimin, në të drejtat e përfaqësimit si në parlament, ku gratë përbënin 33% të numrit të deputetëve, edhe pse aty ato nuk kishin ndonjë fuqi, por kjo ishte për të dyja gjinitë, pra si për gratë edhe për burrat. Të drejtat e gruas lidhur me familjen, divorcin,

marrëdhëniet e pronësisë, të nënës dhe fëmijës, përfshirë zgjatjen e lejes së paslindjes, e cila nga 45 ditë u bë një vit etj., një e drejtë e fituar që nënat e gëzojnë edhe sot, të gjitha këto e të tjera që lidhen me shërbimet për nënën e fëmijën edhe në fshat, si konsultoret etj., pa dyshim që sollën ndryshime pozitive në jetën e grave.

Natyrisht, gratë kanë vuajtur privimet që kishte e gjithë shoqëria shqiptare në një sistem të mungesës së lirive politike, ekonomike, lirisë së mendimit, të shprehjes, lirisë së lëvizjes e të besimit fetar, në një sistem të varfërisë etj., të cilat edhe pse ishin për të gjithë qytetarët, pesha e tyre për gruan ishte më e rëndë edhe për shkak të barrës që ajo mbante në familje.

Faza e tretë e feminizmit, nëse mund të quhet e tillë për Shqipërinë, pasi në rastin tonë feminizmi nuk ka kaluar fazat si në vendet perëndimore, nuk ka të njëjtën formë apo trajektore; fillon pas vitit 1990. Pas rënies së komunizmit, lëvizja e gruas kishte frymëzim perëndimor, të orientuar nga barazia dhe drejtësia gjinore dhe shoqatat e grave ishin ndër të parat organizata të shoqërisë civile të krijuara në Shqipëri. Sot diskutojmë tërësisht në një tjetër kontekst politik, social, ekonomik, kulturor, demografik gjithashtu, në një shoqëri më të hapur, me medie e teknologji informacioni të zhvilluara, në një shoqëri më urbane e më të globalizuar që ka prodhuar efekte në thyerjen e familjes patriarkale, në mundësitë e pakufizuara për informim, ndryshime që natyrshëm bartin me vete dhe probleme sociale.

I gjithë ky kontekst lokal dhe ndërkombëtar ka ndikuar edhe në qasjen ndaj çështjes së gruas duke kaluar nga qasja tradicionale në një perspektivë tjetër, në atë *mainstream* më përfshirëse, në atë të trajtimit të statusit të gruas si e drejtë njerëzore, e cila edhe në vende të tjera e me traditë feminizmi ka ardhur më vonë.

**Ju keni thënë shpesh se: Kur Hillari Klinton (në atë kohë, Zonja e Parë e SHBA-së) në Konferencën e OKB-së për Gruan, të zhvilluar në Pekin më 5 shtator 1995, bëri deklaratën e famshme: “Nëse ka një mesazh që vjen nga kjo konferencë, le të jetë që të drejtat njerëzore janë të drejta të grave dhe të drejtat e grave janë të drejta njerëzore, njëherë e përgjithmonë”, pak veta e menduan ndikimin që do të kishte në qasjen ndaj çështjes së gruas... Duket se kjo sintezë do të kishte një ndikim dhe në lëvizjen e gruas në Shqipëri...**

Në fakt, ajo deklaratë e Hillari Klintonit pati një ndikim të jashtëzakonshëm përtej kufijve të një vendi të vogël, po natyrisht e gjithë Konferenca e Pekinit pati një ndikim thelbësor edhe në Shqipëri. Koncepti se të drejtat e grave janë të drejta njerëzore u bë pjesë e shumë dokumenteve ndërkombëtare për barazinë dhe drejtësinë gjinore dhe në ato për të drejtat e njeriut gjithashtu. “Human rights are women’s rights and women’s rights are human rights once and for all”, deklaroi Hillari Klinton. Konferenca e Pekinit e vitit 1995, pati ndikim të ndjeshëm edhe në lëvizjen e gruas në Shqipëri, në përpjekjet e saj për ta sjellë



çështjen e të drejtave të grave në vëmendjen e opinionit publik e në agjendën e vendimmarrësve; sidomos në krijimin e bazës ligjore, strategjive dhe të politikave të tjera të nevojshme, por edhe në ngritjen e mekanizmave institucionale për zbatimin e tyre në praktikë; në ngritjen e qendrave të shërbimeve sociale, sipas praktikave më të mira të vendeve europiane. Po pa dyshim që ka pasur efekt edhe në rritjen e ndjeshmërisë dhe përgjegjësisë, edhe në politikëbërje.

Ndërkohë që lëvizja e gruas ka luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm për ndërgjegjësimin e politikëbërjes dhe përgjithësisht të shoqërisë, por veçanërisht të vetë grave për të drejtat e tyre. Kjo është thelbësore. Nëse njerëzit nuk i njohin të drejtat e tyre nuk do t'i kërkojnë dhe po nuk i kërkuan vetë, vështirë që këtu të kujtohej njeri për gratë sidomos në kushtet e një vendi me një tranzicion të vështirë e shpesh me ngërçe dhe kriza politike, që marrin gjithë vëmendjen e vendimmarrjes, madje edhe të gjithë shoqërisë. Opinioni ynë është shumë më i ndjeshëm ndaj punëve të politikës sesa atyre që lidhen me jetën dhe përditshmërinë e tyre. Angazhimi ynë në fillimet e lëvizjes ka qenë një rrugë jo e lehtë. Kujtoj seminarin e parë për të drejtat e grave për zgjedhjen e lirë dhe të drejtat riprodhuese, që kishim organizuar në një sallë të ish-hotel “Arbanës” me mbështetjen e BE-së, kur një kameraman televiziv hyri në sallë për të filmuar aktivitetin, në të cilin ishin pjesëmarrës edhe 2-3 burra, të cilët mbuluan fytyrën me dorë, që të mos i fiksonte

kamera, sepse ishin pjesëmarrës në një mbledhje për gratë edhe pse ishin nga ata që mbaheshin si njerëz mendjehapur. E kam të freskët edhe sot këtë skenë të vitit 1993.

Sot për shumë njerëz, sidomos për të rinjtë, ndoshta duket e pabesueshme po opinioni publik i asaj kohe nuk është ai i sotmi, ditët e fundit në një protestë të shoqërisë civile për rastin e një vajze 15-vjeçare, të dhunuar në një shkollë në Tiranë, kam parë një të ri, i cili mbante në dorë një tabelë ku thuhej “Burrat e vërtetë janë feministë”, e kanë bërë këtë konfirmim edhe burra të tjerë, përfshirë edhe Edi Ramën e ndonjë tjetër, edhe pse ende të rrallë. Natyrisht, që mund të biesh dakord ose jo me ta, kjo është tjetër gjë, po e vërteta është se Shqipëria ka ndryshuar shumë dhe e rëndësishme është që njerëzit të ndihen të lirë e të thonë atë që besojnë ose atë çka ata janë dhe kjo nuk është pak për një shoqëri me një të shkuar shumë tradicionale. Sot gjithnjë e më shumë ka përfshirje të të dyja gjinive në çështjen e gruas, megjithëse vështirë ta themi këtë për zonat rurale ku ende nuk është e lehtë dhe Shqipëria në një masë të konsiderueshme është rurale.

E vërteta është se shumë gjëra kanë ndryshuar, falë edhe një lloj sensibiliteti të të gjithë shoqërisë, po duhet pranuar se kjo ka ndodhur edhe falë vullnetit politik, sot kemi një set ligjesh dhe politikash gjinore që janë në të njëjtat standarde me vendet e zhvilluara e për këtë duhet njohur merita e madhe e shoqatave të grave dhe e organizatave të tjera të shoqërisë civile, që janë *gender*

*sensitive* e që kanë kontribuar jo vetëm me kërkesat dhe presionin e tyre, po edhe me ekspertizën për hartimin e ligjeve në standarde, që krijojnë garantët ligjorë për barazi e drejtësi gjinore, por e vërteta është se sot kemi një politikë shumë më të hapur, të emancipuar e vlerësuese ndaj çështjes. Ka një partneritet më të mirë mes palëve.

Ligji për Barazi Gjinore, i miratuar në vitin 2004 e më vonë i përmirësuar, që përfshin edhe kuotën gjinore për përfaqësimin politik dhe vendimmarrjen; ligje të tjera, si ato që trajtojnë dhunën me bazë gjinore, ekonominë e financat, punësimin e grave, të drejtat pronësore, shëndetin dhe të drejtat riprodhuese, trafikimin e qenieve njerëzore dhe shumë të tjera, që afektojnë direkt ose indirekt çështje të barazisë gjinore, kanë krijuar një bazë mjaft të mirë garantësh ligjor. Platforma e Qeverisë Shqiptare për Gratë, e bërë në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, u miratua në vitin 1999 në frymën e Konferencës së OKB-së për Gruan, e njohur si Konferenca e Pekinit, u fokusua në katër nga dymbëdhjetë fushat e konsideruara si problematike për gruan: barazia gjinore në politikëbërje dhe vendimmarrje, në ekonomi, në mbrojtjen sociale dhe në atë të shëndetit. Ky dokument, që pasoi me strategjitë, ka qenë gjithashtu një instrument i rëndësishëm edhe pse jo gjithmonë efikas sa i takon zbatimin e tyre.

Sidoqoftë, jam e bindur se çështja e barazisë gjinore nuk zgjidhet me një set ligjesh apo edhe politikash, sado të mira të jenë ato. Pa dyshim që është një start i mirë, po jo një finish. Mbyllja e hendekut ekzistues mes ligjeve

dhe politikave të mira dhe zbatimit të tyre në terma realë, hendek që, në fakt, është për gjithë legjislacionin që ne kemi prodhuar, jo vetëm për atë gjinor, mbetet sfida për shoqërinë shqiptare në përgjithësi dhe për të gjitha strukturat vendimmarrëse në veçanti. E vërteta është se në disa fusha të të drejtave ka një ndryshim të dukshëm, ndërkohë që në të tjera si ajo e dhunës me bazë gjinore jemi ende larg.

Kemi arritje mbresëlënëse sa i takon përfaqësimit të grave në politikë dhe sidomos në nivelet e qeverisjes qendrore dhe në parlament; 10 vjet më parë gratë zinin vetëm 6.7 % të vendeve në parlament dhe vetëm një grua ministre. Sot numri i grave deputete është rritur gati katër herë dhe kjo nuk është pak. Shqipëria sot renditet e katërta në botë sa i takon përfaqësimit në kabinetin qeveritar me 8 gra ministre nga 15 gjithsej, ose 53.3 %. Gjithashtu, në administratën publike numri i grave është rritur dhe mund të themi se përfaqësimi i tyre i kalon edhe disa vende të zhvilluara.

Pa dyshim që fuqizimi i grave në vendimmarrje nuk është thjesht çështje numrash, shkon përtej numrave dhe duhet pranuar se është një nisje pozitive. Po pa bërë moralisten, dua të them se kur vjen puna për politikën dhe përgjithësisht vendimmarrjen në të gjithë sektorët, përfshirë atë vendore, duhet bërë kujdes - nuk duhet të ulim standardet për hir të gjinisë - se kjo do t'i bënte një dëm më të madh vendit, do ta komprometonte edhe qëllimin e mirë, kur ai është i vërtetë, dhe raste të tilla kanë ndodhur.

**Pas viteve 90-të nga politika dhe shoqëria civile është artikulluar gjithnjë e më shumë ideja e rritjes së pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen vendore, duke besuar se arritja e një mase kritike të grave do të sjellë ndryshim: nxitje të barazisë gjinore dhe zhvillim. Vitet e fundit niveli i grave në vendimmarrje është gjithnjë e më tepër dominues. Ju e keni quajtur shpesh në deklarata si një arritje të madhe përfshirjen e grave në qeverisjen vendore. Po çfarë ka sjellë ky angazhim përtej kuotave?**

Gjithsesi falë një angazhimi serioz ne kemi prodhuar një cilësi të re me përfshirjen e grave në nivelin e qeverisjes vendore, sidomos në nivel të këshilltarëve, sepse për sa i takon kryebashkiakëve jemi ende larg, me gjithë një rritje modeste të numrit të grave. Vendosja e kuotës gjinore, që përcakton se pesëdhjetë për qind e kandidatëve për këshilltarë bashkiakë duhet të jenë gra e ka dhënë rezultatin. E quaj arritje të madhe përfshirjen e tyre në qeverisjen vendore, se përveç së drejtës së përfaqësimit, me Reformën Territoriale dhe Decentralizimin, një sërë kompetencash e shërbimesh jetësore u kalojnë bashkive dhe unë besoj se përfshirja e grave në vendimmarrje në qeverisjen vendore, është mënyra më e mirë për të afruar qeverisjen te njerëzit dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

E dyta, përmes këtij procesi ne krijojmë një potencial për politikën qendrore - parlament e qeverisje, sidomos në rastin e parlamentit. Angazhimi i grave në qeverisjen

vendore është një ushtrim shumë eficient për një karrierë sipas meritës, për prurje të reja në parlament dhe qeverisje qendrore që zgjedhja të bëhet jo sipas rastësisë apo preferencave personale, por sipas meritës që vjen pas një eksperience e karriere të ndërtuar vetë. Ndërkohë ky ndryshim, që solli më shumë gra në qeverisjen vendore, theu edhe një mit. Më përpara kur kërkonim kandidate gra na thoshin nuk ka gra në rrethe dhe sidomos në zonat rurale, por kur ligji i detyroi zbuluam që kishte gra dhe madje shumë të zonjat për të bërë këshilltaren, madje edhe kryebashkiaken.

Në të dyja rastet, si në rastin e politikës qendrore edhe në atë lokale, kuota gjinore ka qenë një instrument i rëndësishëm për rritjen e përfaqësimit të grave në politikë dhe përgjithësisht në vendimmarrje, kështu mund të them se ka qenë një nga arritjet tona edhe si gra deputete bashkë me ato të shoqërisë civile. Natyrisht që ka mendime të ndryshme pro dhe kundër sa i takon kuotës gjinore, ndërsa unë mendoj se kuota është e nevojshme si një masë e përkohshme, si një instrument që krijon një shtrat ligjor mbështetës për mosdiskriminim gjinor e pse jo edhe për inkurajimin e grave për të kandiduar. Po kjo nuk është kuotë për gratë siç thuhet në përditshmëri, është kuotë gjinore, çka do të thotë se është një instrument mbrojtës për të dyja gjinitë, është një ligj që ka në themel barazinë dhe drejtësinë njerëzore pavarësisht nga gjinia, ka në themel jo mëshirën apo favorizimin për njërën gjini ose për të ashtuquajturin seks i dobët, por të drejtat

e barabarta. Nëse nesër do të kemi më pak burra në parlament kuota është edhe për ta.

Pa dyshim që fuqia e gruas në vendimmarrje nuk ka të bëjë thjesht me numrat, ato janë të rëndësishëm, madje shpesh ndikojnë për të kaluar nga ndryshime sasiore në cilësi.

A ka ndodhur gjithmonë kështu?

Vështirë ta them. Po gjithsesi besoj se ndryshimet nuk vijnë kaq shpejt, është një hap i rëndësishëm, sfida është të krijojmë qëndrueshmëri në çka kemi arritur, një arritje e rëndësishme që duhet vlerësuar dhe çuar përpara.

E vërteta është se nënperfaqësimi i grave në politikë dhe përgjithësisht në vendimmarrje nuk është një problem shqiptar, është edhe në vende të zhvilluara, madje edhe brenda BE-së; shumë vende ende nuk kanë arritur një ekuilibër gjinor në përfaqësim, kanë hendeqe jo të vogla. Kjo është më e dukshme sa i takon përfshirjes së grave në pozicione menaxheriale. Sipas Christine Lagarde, ish-drejtoreshë e FMN-së, sot drejtoreshë e Bankës Qendrore Europiane, gratë sot në botë përbëjnë vetëm 5 % të 500 pozicioneve të larta të drejtuesve ekzekutivë (CEO) dhe 24 % të pozicioneve menaxheriale. Në rastin tonë shifra është pak më e lartë, po natyrisht flitet për nivele të ndryshme përfaqësimi sa i takon nivelit dhe madhësisë së sipërmarrjeve që gratë drejtojnë këtu dhe ato në botë ku në disa raste bëhet fjalë për kompani shumëkombëshe.

Ndërkohë që shpesh te ne, rritja e numrit të grave në disa pozicione, është më shumë një model i mbështetur në njohje e preferencë personale, jo se në vende të tjera nuk ka raste që promovimi i grave, ashtu si dhe i burrave në politikë lidhet me preferenca personale, por minimalisht kalojnë përmes një përvoje, ka një proces vlerësimi e disa filtra ose të paktën nuk e marrin vesh në TV se u bënë ministra apo se lënë postin. Besoj se përveç ftesës për të marrë një pozicion, njeriu ka dhe një zgjedhje të tijën/sajën personale, që do të thotë duhet të pyetet nëse e pranon pozicionin që i ofrohet apo jo. Ky mekanizëm krijon padrejtësi madje dhe komprometim të vetë kauzës dhe sistemit. Natyrisht kjo lidhet edhe me mënyrën e funksionimit të vendimmarrjes brenda partive politike, prandaj mendoj se na duhet ta marrim seriozisht nevojën e demokratizimit të vetë partive politike, për të krijuar një mjedis më përfshirës, që mbështetet në vlerat dhe kontributet e jo në lidhjet personale, gjë që do të sillte më shumë vlera e cilësi në politikë dhe në gjithë vendimmarrjen. Gjithsesi ky problemi i nevojës imediate për demokratizimin e partive politike nuk është diçka e lidhur vetëm me çështjen e gruas, apo përgjithësisht me karrierën në parti politike, por ka të bëjë me të gjithë demokracinë e funksionimit të një partie politike e përtej, ky është një diskutim shumë i nevojshëm sot e që meriton ta diskutojmë si çështje më vete.

Në fakt çështja e fuqizimit të grave është komplekse, nuk është vetëm çështje e të drejtave të grave për t'u



përfaqësuar, po unë besoj fort se roli i grave është kyç për zhvillim të qëndrueshëm të një vendi. Kur ka pabarazi ajo kthehet në një problem jo vetëm për gratë, por për të gjithë shoqërinë dhe për vetë zhvillimin e vendit. Pabarazia gjinore përbën një pengesë serioze për uljen e varfërisë dhe për zhvillim të qëndrueshëm. Dhe ky nuk është një slogan, përkundrazi këto të dyja janë të lidhura e të ndërvarura nga njëra-tjetra: nuk ka zhvillim të qëndrueshëm të një vendi pa integrimin e grave në proces dhe nuk ka zgjidhje të problemit gjinor pa një zhvillim të qëndrueshëm. Natyrisht zgjidhja e kësaj paradigme kërkon një qasje të integruar, sa kohë që sfidat janë komplekse e të ndërlidhura me njëra-tjetrën eksperiencia e shumë vendeve ka treguar se pabarazia gjinore përbën një pengesë serioze për uljen e varfërisë dhe për zhvillim të qëndrueshëm.

Ndërkohë kur flasim për fuqizim të grave dhe integrim të tyre në zhvillimin e qëndrueshëm, edukimi është kyç, është kyç jo vetëm për t'i integruar ato në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, por edhe për zhvillimin ekonomik e për të ulur varfërinë në vend, sidomos si një mjet kundër feminizimit të varfërisë. Po përdor vetëm dy tregues që flasin shumë. Sipas statistikave gratë bëjnë 70 % të shpenzimeve konsumatore, jo domosdosmërisht të tëra për veten e tyre, por e kuptueshme për të gjithë familjen.

Por po ashtu gratë janë kategoria më e predispozuar për të rënë në kurthin e varfërisë dhe një nga problemet që e bën jo shumë të dukshme në agjendat, që adresojnë probleme të zhvillimit njerëzor në Shqipëri, ka qenë edhe

varfëria e të dhënave statistikore ose mosnjohja e tyre, kur ato ekzistojnë. Gjithsesi, po t'i hedhim një vështrim të kujdesshëm të dhënave, ato na bëjnë një lidhje direkte të varfërisë së grave me nivelin e tyre arsimor dhe integrimin ekonomik të tyre. Kështu 75 % e grave që jetojnë në varfëri, kanë nivel të ulët arsimimi, kjo ka të bëjë kryesisht me zonat rurale dhe me ato periurbane ku shpesh detyrohen edhe nga rrethanat të ndërpresin shkollën qysh në moshë të hershme.

Po kur flasim për një kategori të caktuar të grave, që sapo përmenda, kjo nuk do të thotë se ne nuk kemi potenciale grash për të kontribuar në vendimmarrje dhe në zhvillimin e vendit. Të dhënat tregojnë se gratë kanë potencial për t'u integruar plotësisht në zhvillimin e qëndrueshëm dhe pa dyshim që arsimi është vendimtar për këtë ndërmarrje. Ato i kanë të gjitha mundësitë për të mbajtur një peshë të rëndësishme. Kur vjen puna tek arsimi i lartë, vajzat përbëjnë 56 % të të gjithë studentëve dhe 63.3 % të të diplomuarve, çka duket qartë se ato performojnë më mirë edhe sesa kolegët e tyre e për rrjedhojë po bëhen më të arsimuara dhe kanë potencial për të qenë në udhëheqje të proceseve politike dhe të zhvillimit të vendit. Megjithatë, pavarësisht arsimimit të tyre, të dhënat tregojnë se gratë janë më pak të paguara sesa kolegët e tyre, edhe pse Shqipëria nuk hyn ndër vendet që kanë një diferencë të madhe në nivelin e pagave mes grave dhe burrave, madje në katër vitet e fundit ky hendek është ngushtuar. Hendeku i barazisë

gjinore për pagat në Shqipëri, sipas INSTAT-it është 10.4 % (viti 2018), ndërkohë që në vitin 2019 ishte 13,7 % çka tregon për një tendencë në rritje. Gjithsesi, në vendet e Bashkimit Europian, sipas Eurostatit, hendeku mesatar gjinor për nivelin e pagave vlerësohet të jetë në 16 %, po kjo nuk duhet të na vetëkënaqë, sepse me nivelin e pagës mesatare që ka Shqipëria në raport me vendet e BE-së, efekti ekonomik i diferencës në pagë është më i madh.

Përfaqësimi i barabartë i grave dhe i burrave në vendimmarrje duhet parë jo vetëm si një e drejtë themelore, por edhe si nevojë e shoqërisë për kontributin e tyre, sepse nga nënpërfaqësimi i gjysmës së shoqërisë në vendimmarrje, nuk humbasin vetëm gratë po humbet e tërë shoqëria, nga mospërdorimi eficient i këtij potenciali njerëzor. Të dhënat e mësipërme tregojnë se gratë përbëjnë sot një resurs të madh jo vetëm numerik, por edhe një potencial profesional e intelektual për të cilin ato vetë, por edhe shoqëria, kanë investuar dhe kur ky investim nuk përdoret në shërbim të vendit humbasim të gjithë.

Ndërkohë që ka një hendek mes rurales dhe urbanes. Ende vazhat në fshat janë në vështirësi arsimimi, qoftë për shkaqe sociale, të mentalitetit të familjes, qoftë për shkak të kushteve ekonomike apo kushteve të tjera si distanca fizike, mungesa e transportit e të tjera, pa folur për analfabetizmin funksional të atyre që formalisht quhen me shkollë dhe kjo e fundit është për të dyja gjinitë, po

më shumë për vajzat, të cilat familjet i heqin nga shkolla pa e përfunduar të mesmen edhe për shkak të mentalitetit. Unë besoj se fuqizimi ekonomik i grave dhe i vajzave, me fokus të veçantë zonat rurale, mbetet një problem i madh, ashtu si mbetet një sfidë edhe statusi social i tyre, përballja me vështirësi e mungesa në shërbime sociale e shëndetësore të arritshme e të përballueshme, që ndihmon edhe në përballjen e dilemës familje-karrierë.

Na duhen politika ekonomike përfshirëse nga perspektiva gjinore, ashtu si dhe për edukimin dhe sidomos formimin profesional të përshtatur me kërkesat e tregut të punës apo mundësi vetëpunësimi që integrojnë gratë në ekonominë e vendit dhe zbutin varfërinë sidomos në zonat rurale.

Na duhet të gjejmë përgjigje për dilema të tilla duke integruar gjerësisht çështjet gjinore në të gjitha elementet e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Po sjell një shembull jo nga Europa, ku dihet se vendet me standard më të lartë zhvillimi kanë përfaqësim më të mirë të grave, por nga Ruanda, një vend që ka ecur shumë dhe që sot po merret si referencë edhe nga shumë vende dhe organizata ndërkombëtare. Gratë zënë 53 % të vendeve në parlament e njëherësh ka edhe rritje të dukshme në pozicione menaxheriale. Falë kësaj politike, Ruanda ka bërë një progres impresiv në rritjen ekonomike, uljen e varfërisë dhe të pabarazive në vend. Kryeministri japonez, Shinzo Abe, në një fjalim për nevojën e rritjes së përfaqësimit të grave në vendimmarrje, mbështetur në

të dhënat e një studimi, ka deklaruar se rritja e numrit të grave në vendimmarrje rrit 9 % GDP-në dhe kjo është një e vërtetë e provuar në disa vende. Ndërkohë po i rikthehem Christine Lagarde-s, e cila deklaronte në Forumin e Davosit të vitit 2019, se sipas një studimi të fundit “eliminimi i boshllëqeve gjinore në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore mund të rrisë PBB-në me 5 deri në 8 për qind”. Këto janë studime dhe eksperiencë që vijnë nga vende shumë të ndryshme, por që mesazhi është një: më shumë gra të fuqizuara, shoqëri më të drejtë e më të prosperuar ekonomikisht.

Ka edhe një problem që lidhet me vizionin dhe mënyrën e trajtimit të çështjes së fuqizimit të grave dhe rolit të tyre në vendimmarrje. Në kulturën tonë qasja ndaj këtij problemi shpesh është orientuar jo si një detyrim i shoqërisë, jo si një e drejtë njerëzore, jo si një nevojë e vendit për të rritur potencialet, po si një mirësi apo favor që u bëhet grave. Qasja përdoruese, për vota, është një tjetër qasje që përdoret shpesh nga politika, ndërkohë që në disa raste zgjedhja e gabuar, zgjedhje jo sipas meritës po sipas preferencës, i ka bërë një dëm të madh çështjes së përfshirjes së grave në politikë dhe përgjithësisht në vendimmarrje. Pa dyshim që këto qasje nuk na çojnë në zgjidhje të qëndrueshme dhe nuk i shërbejnë as vendit e as vetë grave, përkundrazi e komprometojnë kauzën.

Ndërkohë që kur flasim për një vend që do të integrohet në BE, duhet të jemi të qartë se një demokraci nuk

mund të jetë funksionale me të drejta dhe barazi vetëm për gjysmën e shoqërisë dhe demokracia funksionale është një nga kriteret kyç të Kopenhagës. Një shoqëri nuk mund të ketë demokraci funksionale nëse gjysma e saj është e nënperfaqësuar, nëse niveli i dhunës me bazë gjinore është në nivele të larta. Jo rastësisht ka një lidhje reciproke mes fuqizimit të grave dhe nivelit të demokracisë dhe zhvillimit të një vendi. Të gjithë e dimë se vendet me nivel më të lartë përfaqësimi e respektimi të të drejtave njerëzore si Suedia, Islanda, Holanda, Norvegjia, Danimarka, Gjermania, Franca etj., janë vende me standarde të larta demokracie dhe zhvillimi ekonomik e social e kanë edhe një ekuilibër më të mirë gjinor.

**Po ju kujtoj një thënie nga fjalimi i Margaret Atwood-it, në një konferencë mbi shkrimtarët gra disa vite më parë, ku thotë se “problemet e grave nuk kanë përfunduar, përderisa ende bëjmë një konferencë me autoret gra; kjo gjë nuk ndodh me burrat”... Më shumë se ndryshim i një koncepti gjinor, përfshirja e grave në kuota politike shpesh ka qenë çështje numrash...**

Sa i takon pjesës së parë kur Atwood<sup>1</sup> thotë se “problemet e grave nuk kanë përfunduar, përderisa ende

---

<sup>1</sup> Margaret Atwood është shkrimtare, kritike letrare dhe aktiviste kanadeze, autore e më shumë se 60 librave: romane, ese, poezi dhe libra për fëmijë. Është nderuar me shumë çmime letrare, ndër të cilat “Booker Prize”, “Princi i Asturias” dhe “Franz Kafka Prize”.

bëjmë një konferencë me autoret gra, kjo gjë nuk ndodh me burrat”, kjo është një e vërtetë që duket si një nevojë apo dhe si arsyetim që gratë janë më mbrapa, çka ndodh jo vetëm me krijimtarinë, po nëse do të shohim kanë ecur gratë, ndryshimi është i madh dhe prurja është optimiste. Mjafton të shohim se sa janë shtuar gratë që kanë marrë çmime prestigjioze ndërkombëtare, përfshirë dhe çmimin “Nobel”, po unë mendoj se nuk është këtu problemi, gjithnjë e më pak duhen bërë konferenca, takime e aktivitete të grave duke i ndarë ato sipas gjinisë. Personalisht jam për qasje bipartizane në kuptimin jopolitik të fjalës, qoftë dhe kur flitet për krijimtarinë e grave, insistoj që kjo nuk është një çështje e grave për gratë.

Sa i takon kuotës ka një debat pro dhe kundër, por siç e kam thënë edhe më lart përfshirja e grave në politikë për mua nuk është çështje numrash, sepse kjo i kthen gratë në vendimmarrje fasadë. Dhe eksperiencia ka treguar edhe modele të koperturave, po kjo është po aq e vërtetë edhe për burrat dhe unë nuk mendoj se çështja e paaftësisë në politikë është problem vetëm për gratë, për burrat është po aq problem, madje edhe më shumë kur paaftësia përzihet edhe me probleme të tjera, atëherë dëmi është edhe më i madh. Gjithsesi kur flasim për gratë mendoj se ato nuk duhet të diskriminohen për shkak të gjinisë, dhe nuk duhet të jenë në pozicione për shkak të gjinisë, por për shkak të vlerave.

Dhe dua të kujtoj Tomas Chamorro Premuzic<sup>1</sup> kur në librin e tij “Pse kaq shumë burra të paaftë bëhen liderë?”, thotë se nuk na duhet përfaqësimi që shërben si fasadë, “Ne duhet t’i promovojmë njerëzit falë kompetencës, përvullësisë dhe integritetit dhe kjo duhet të funksionojë njëjloj si për burrat ashtu edhe për gratë, te të cilat unë besoj se mund t’i gjesh më shumë këto cilësi, të paktën atë të gatishmërisë dhe të integritetit, sepse ajo e kompetencës besoj varet nga njeriu”, shkruan ai.

Po nëse flasim për feminizëm, që ka në thelb barazinë dhe drejtësinë gjinore, që e kam thënë edhe më lart, kuota është vetëm një instrument nxitës, madje mendoj i përkohshëm derisa të krijojmë një kulturë e qëndrueshmëri në sistemin e përfaqësimit me të drejta të barabarta. Neve na duhet të avancojmë agjendën për fuqizimin e grave, si një e drejtë e tyre e si një nevojë e vetë shoqërisë gjithashtu, që gjysma e shoqërisë të mos jetë e nënpërfaqësuar ose formalisht e përfaqësuar. Së dyti, mendoj se çështja e barazisë gjinore nuk është

---

<sup>1</sup> Tomas Chamorro-Premuzic është psikolog organizativ, përzgjedhësi kryesor i talenteve në Manpower Group; profesor i psikologjisë së biznesit në “University College London” dhe në “Columbia University” në Nju-Jork; bashkëpunëtor në Laboratorin e Financës dhe Sipërmarrjes në Harvard. Është mes të tjerash autor i librit “Pse kaq shumë burra të paaftë bëhen liderë?”, mbi të cilin bazohet edhe fjalimi i tij në TEDx.



thjesht një çështje morale, është një e drejtë njerëzore dhe realizimi i të drejtave njerëzore është detyrim i gjithë shoqërisë e jo vetëm i palës së prekur, që në këtë rast janë gratë. Nuk është një çështje vetëm e grave, nuk është betejë për vetveten, në radhë të parë është një çështje përgjegjësie e institucioneve shtetërore, por edhe e gjithë shoqërisë. Ende shoqëria jonë ka mite dhe keqkuptime sa i takon çështjeve gjinore.

Shpesh te ne ka një keqkuptim sa i përket konceptit të barazisë, është e paqartë nëse flitet për barazi apo barazi të mundësive? Personalisht mbështes e besoj në barazinë e mundësive, që kupton trajtim të barabartë për gratë dhe burrat në ligjet dhe politikat dhe akses të barabartë ndaj burimeve dhe shërbimeve brenda familjes, në komunitet dhe në shoqëri, shoqëritë e përparuara krijojnë mundësi të barabarta.

Gjithsesi, kjo është një temë që më duket me mjaft interes për t'iu rikthyer e diskutuar më gjerë. Pa dyshim kemi një rrugë të gjatë për të bërë derisa gratë të mos jenë viktimat të dhunës; derisa gratë të kenë të njëjtat mundësi ekonomike, në punësim, në pagë, në burimet financiare, në çështje të pronës, të mundësive për kredi; në shërbime sociale të arritshme e të përballueshme, pavarësisht nëse ato jetojnë në fshat apo në qytetet. Është veçanërisht i nevojshëm fokusimi te gratë me nevoja specifike, si ato të kthyera nga emigracioni, ato të zonave rurale, gratë rome, ato të papuna që përgjithësisht janë edhe të pazëshmet etj.

**Në Shqipëri kur flasim për gratë, nuk mund të shmangim një temë ende shumë të ndjeshme siç është dhuna ndaj tyre. Përse ende shumë gra nuk kanë mundur të shpëtojnë nga ky nënshtrim i egër maskilist në familje?**

Dhuna ndaj grave është një nga çështjet për të cilën flitet më shumë sot edhe për shkak të përmasës që ka marrë, por edhe për shkak të sensibilitetit më të lartë të shoqërisë civile dhe medias. Sot dhuna ndaj grave në familje, është një problem serioz dhe këtë e thonë jo pak, po 75.4 % e grave të intervistuar në një studim të fundit, të cilat mendojnë se dhuna ndaj grave në familje është një problem i madh. Viti 2019 pati mbi 3000 raste dhune me bazë gjinore të raportuara, ndërkohë që dihet se në Shqipëri ajo është e nënraportuar, shumë gra nuk guxojnë të shkojnë të raportojnë në polici, ka të tjera që nuk kanë as informacion për këtë mundësi, pra nuk i njohin të drejtat e tyre dhe institucionet ku mund të drejtohen. Ka dhe nga ato që ende mendojnë se burri ka të drejtë ta rrahë gruan. Natyrisht, problemi i dhunës ndaj grave është kompleks, është problem social, kulturor, ka të bëjë me mentalitetin, edukimin, me arsye ekonomike etj. Shpesh çështja e dhunës me bazë gjinore trajtohet si çështje policimi apo sa herë rritet ndjeshmëria i kthehemi kodit penal për ta ndryshuar. Natyrisht, përmirësimet që i janë bërë për ndëshkimin e dhunës kodit penal janë shumë të rëndësishme po a mjaftojnë? Natyrisht që jo. Sa i takon arsyeve janë disa faktorë që lidhen me kulturën,

me reminishenca të marrëdhënieve patriarkale në familje, me faktorë të tjerë socialë, ekonomikë që janë përmendur më lart.

**Sa i vështirë është ky progres në një shoqëri që e ka legjitimuar dhunën që në shekullin XIV, në atë që njihet si ligji patriarkal i shqiptarëve “Kanuni” i Lekë Dukagjinit, ku thuhet për gruan se ajo është “shakull për të bajtur”, “ajo asht një calikë për me bajtë sa të jetë në derë të burrit”...**

Sa i takon çka kam thënë në këto shënime për “Kanunin” e Lekë Dukagjinit, sidomos në raport me gruan, megjithëse ka edhe sot njerëz që mendojnë ndryshe për të dhe që e vlerësojnë, pa hyrë në diskutimin për të si dokument, për vlerat historike të tij, besoj që duhen ndarë gjërat dhe sidomos ajo që ka të bëjë me gruan. Për mua pozita që i jep “Kanuni” gruas është jo thjesht e padrejtë, po çnjerëzore. Po citoj vetëm një pjesë të vogël të asaj se çfarë “Kanuni” i Lekë Dukagjinit thotë për gruan e që lidhet me pjesën e tagrit që i jep burrit në raport me gruan, po ka edhe pjesë të tjera diskriminuese madje fryma e “Kanunit” për gruan është e tillë:

*Nyje e njëzetetët - Me rrahë burri gruen, nuk bjen në faj. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:19].*

*Nyje njëzetendët - Grueja njëfjet si calikë për me bajtë sa të jetë në derë të burrit, [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:19].*

*Nyje e tridhjetëtrëtet - Burri ka tager; a) me kshillue e me qortue gruen; b) me rrahë e me lidhë gruen e vet, kur të mbërrijë me i a përbuzë fjalën e urdhnin. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:21].*

*Nyje e tridhjetegjashët - Kanuja njef për trashigues djalin e jo vajzën. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:26].*

Ligjërrohet dhuna ndaj gruas dhe nuk pranohet jo vetëm e drejta e fjalës, e drejta e pronës, po dhe e drejta e jetës mbetet në dorën e burrit. Unë besoj se një pjesë e dhunës me bazë gjinore, që edhe sot është në nivele frikshëm të larta, e ka zanafillën aty. Kam pasur rast të dëgjoj gra të dhunuara nga burrat e tyre, të thonë se burri ka të drejtë me të rrahë ose të thonë se kur gabojmë edhe na rrahin.

Po nuk është vetëm kanuni që ka ndikuar, e drejta zakonore e Labërisë, që ka vepruar kryesisht në jugperëndim të Shqipërisë, parashikonte gjithashtu kufizime lidhur me statusin e gruas, veçanërisht në marrëdhëniet familjare, ekonomike apo sociale, por në një masë më të lehtë jo vetëm në normë zakonore, por edhe në zbatimin praktik. E drejta zakonore e Labërisë nuk ka pasur forcën që ushtronte kanuni, ndërkohë që pozita e gruas fitoi një ndryshim më të shpejtë, që erdhi duke u forcuar, edhe për shkak të migrimit të hershëm në botën perëndimore, që solli një ndikim edhe në marrëdhëniet familjare.

Gjithsesi pesha e këtyre faktorëve që lidhen me të shkuarën ka rënë ndjeshëm.

## **A mjaftojnë politikat penale për të çrrënjësuar këto fenomene?**

Natyrisht, siç e përmenda më lart, ligjet janë të domosdoshme, por jo të mjaftueshme sidomos në një vend që sundimi i ligjit mbetet një problem. Gjithsesi, besoj se na duhet një qasje më e integruar që fillon qysh në koncept ndaj fenomenit. Shpesh bëj pyetjen a duhet të flasim më shumë për dhunën apo për fuqizimin e grave? Pa dyshim që këto të dyja janë në një lidhje të ngushtë dhe fuqizimi i gruas është kyç për parandalimin e dhunës, prandaj nëse në diskursin tonë i japim përparësi fuqizimit të gruas, efekti do të jetë më i mirë. Edhe pse vitet e fundit ka një ndjeshmëri më të lartë ndaj çështjeve të barazisë gjinore e sidomos atyre të dhunës me bazë gjinore, falë edhe rolit të medias, debati për të drejtat e grave ka mbetur periferik, dhe përgjithësisht fushator dhe jo rrallë shihet në një optikë të ngushtë. Bie fjala flitet shumë për dhunën ndaj grave, po qasja shpesh është viktimizuese ose me raste edhe depersonalizuese, jo e parë në perspektivën e së drejtës për të jetuar me dinjitet, të drejtën e privatësisë, atë të mbrojtjes së fëmijëve në rastin e nënave dhe flitet pak për detyrimin e institucioneve shtetërore për parandalim të fenomenit e për rehabilitim, riintegrim, ofrimin e mundësive për punësim, përfshirjen etj.

Një grua që kalon një eksperiencë të tillë shpesh shihet ende me dyshim ose si viktimë, por që nuk mund të integrohet, ndaj saj sigurohet një lloj mbrojtjeje dhe

merret një masë e përkohshme për dhunuesin, por jo integrim edhe pse rastet kanë treguar se mbrojtja mbetet gjithashtu një problem i madh i shoqërisë, pasi këto gra shpesh hyjnë në cikël dhune dhe shumica e tyre janë recidiviste dhe nuk janë të pakta në numër, po edhe sikur një grua e vetme të jetë, të drejtat njerëzore janë individuale e duhen trajtuar si të tilla. Te dhuna me bazë gjinore, problemi lidhet edhe me mënyrën e trajtimit të çështjes e kjo fillon që nga raportimi joetik, joprofesional, shpesh viktimizues ose edhe diskriminues në medie dhe mbi të gjitha joligjor. Mediet shpesh bëjnë deklarime pa miratimin e viktimës duke bërë publike të dhëna që shkelin të drejtën e privatësisë apo konfidencialitetit, në disa raste duke dëmtuar edhe procesin e hetimit. Ka pasur raste që i japin hapësirë deri dhunuesit po jo viktimës. Kjo qasje shpesh demotivon viktimat e dhunës për t'iu drejtuar institucioneve përgjegjëse për denoncim.

Ndërkohë, kur flitet për dhunën në familje fokusi më shumë vjen te policia dhe shpesh trajtohet si një problem policor, natyrisht që policia ka rolin e saj në identifikimin, mbrojtjen e viktimës dhe dënimin e shkelësit, por problemi është se çfarë bëhet më pas? Nuk mjafton dënimi i dhunuesit. Çfarë ndodh me viktimat, a kemi programe rehabilitimi, integrimi?

Problemi është kompleks dhe në radhë të parë social. Mendoj se duhet t'i japim përparësi parandalimit dhe që t'i japësh përparësi parandalimit duhet më shumë investim